

Violeta Shamku

LIBËR PËR MËSUESIN
Muzika 7

BOTIME



Përmbajtja

1. Hyrje

- 1.1. Pse shërben ky libër?
- 1.2. Çfarë synon ky libër?
- 1.3. Çfarë përmban ky libër?

2. Kompetencat dhe kuptimi i tyre

- 2.1. Lidhja e muzikës me *kompetencat kyçe*
- 2.2. Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare
- 2.3. Kuptimi i *kompetencave lëndore muzikore*, i *tematikave* dhe lidhja ndërmjet tyre

3. Planifikimi i kurrikulës – kuptimi dhe zbatimi


- 3.1. Planifikimi vjetor sipas tematikave dhe tremujorëve “Muzika 7”
- 3.2. Planifikimi sipas 3 mujorëve (i ndërthurur)

4. Metodologjia e të nxënit dhe e mësimdhënies bazuar në qasjen me kompetenca në lëndën e muzikës

- 4.1. Planifikimi i situatave të të nxënit
- 4.2. Planifikimi ditor

5. Vlerësimi

- 5.1. Llojet e vlerësimit: Vlerësimi i vazhdueshëm, periodik dhe përfundimtar



Hyrje

I dashur koleg/e!

Muzika është një disiplinë e artit dhe gjuhë universale që i ndihmon nxënësit/et të kuptojnë dhe të lidhin dukuritë muzikore, proceset dhe çështjet që i përkasin muzikës, duke vërtetuar ligjshmërinë e tyre. Shpjegimi i mënyrave të krijimit, të interpretimit dhe të ndërtimit të tyre, çon drejt realizimit të një procesi të suksesshëm të të mësuarit në muzikë. Muzika është disiplina, e cila qëndron mes të gjitha formave të tjera inteligjente të njeriut (arteve në përgjithësi, shkencave shoqërore e historike dhe shkencave artistike), si një përbërës i barabartë me to i progresit intelektual dhe i humanitetit.

Prandaj, zhvillimi i muzikës në shkollë është një vlerë e madhe që mundëson:

- edukimin dhe formimin kulturor;
- zhvillimin e personalitetit të nxënësve/eve,
- zhvillimin e aftësive të tyre për të punuar dhe për të krijuar në mënyrë të pavarur e sistematike si dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike.

› Pse shërben ky libër?

Ky libër do t'u shërbejë mësuesve/eve të muzikës, të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale, duke kuptuar më së miri qasjen me bazë kompetencat dhe zbatimin e saj në kurrikulën e muzikës.

› Çfarë synon ky libër?

Zbatimi i mësimdhënies bazuar në qasjen me **kompetenca**, do të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjithë mësuesit/et e muzikës së AMU-së që do ta ndërtojnë punën e tyre të përditshme duke u bazuar në njohjen e dokumentacionit të ri: *kornizën kurrikulare, kurrikulën bërthamë të arteve, programin mësimor*. Vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes së kompetencave kyçe dhe lëndore, përkohë me tri faza mjaft të rëndësishme:

- a) planifikimin përmes situatave të të nxënësit;
- b) metodologjinë e mësimdhënies;
- c) vlerësimin e të nxënësit duke u bazuar në qasjen e re me kompetenca.

Qëllimi i këtij libri është të orientojë dhe të ndihmojë mësuesit/et që japin mësim në klasën e shtatë, për të përmbushur synimet e kësaj kurrikule, për ndërtimin e *kompetencave lëndore muzikore* dhe *kyçe*, të nxënësit/et e klasës së shtatë, për të planifikuar dhe realizuar detyrat e tyre si mësimdhënës të kësaj lënde, në përputhje me dokumentet zyrtare dhe fazat nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

› Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me draft-programin e klasës së shtatë, përkatësisht shkalla e tretë e lëndës Muzikë, miratuar nga MAS-i, në dhjetor 2014.

Ky libër merr përsipër:

- **të sqarojë** çdo mësues/e të muzikës për të gjitha çështjet e planifikimit, të metodologjisë dhe të vlerësimit, që duhet të zbatojë çdo mësues/e në lëndën e tij.
- **të paraqesë** dokumentet e hartuara dhe mënyrën se si ato duhet të përdoren nga vetë mësuesi/ja në lëndën e muzikës.
- **të udhëzojë** të gjitha formatet e reja: planifikimin *vjetor, tremujor, ditor, situatat e të nxënit, format e vlerësimit* etj., me të cilat duhet të punojë mësuesi/ja gjatë një viti shkollor.

Ndryshe nga çka mësuesi/ja është mësuar të gjejë në një libër mësuesi, ky libër në parim jep dhe ofron modele ose sugjeron modele, por nuk i dikton ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxënit, metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të realitetit dhe të nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim.

Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.



I PROGRAMI MËSIMOR, KOMPETENCAT DHE KUPTIMI I TYRE

Ky libër ka si qëllim krijimin e kushteve për ndërtimin e **kompetencave të lëndës së muzikës** si dhe të **kompetencave kyçe**, të cilat realizohen nëpërmjet njëra-tjetrës, realizimin e **temave ndërkurrikulare** edhe nëpërmjet lëndës së muzikës, i cili është gjithashtu një përbërës i rëndësishëm i programit të muzikës, për kontributin e muzikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në këtë libër, gjithashtu, përshkruhet **lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare**, në mënyrë që kurrikula e arsimit parauniversitar të funksionojë si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor, atë të formimit të nxënësve/eve.

Muzika zhvillohet në të gjithë arsimin e detyruar përmes 4 shkallëve, që përfshijnë **arsimin fillor (AF)** klasat 1- 5 dhe **arsimin e mesëm të ulët (AMU)** klasat 6-9, pra dy cikle arsimimi, të cilat përfshijnë brenda tyre 9 vite shkollimi.

Të katërta shkallët grupohen në mënyrë të tillë:

- **shkalla e parë:** parashkollori (mosha 5-6 vjeçare) – klasa dytë
- **shkalla e dytë:** klasa e tretë – klasa e pestë
- **shkalla e tretë:** klasa e gjashtë – klasa e shtatë
- **shkalla e katërt:** klasa e tetë – klasa e nëntë

1.1 Kompetencat kyçe dhe muzika

Kurrikula e re me bazë **kompetencat** ka filluar të zbatohet tashmë në mjediset mësimore, pikërisht në klasat 1-6. Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave kontekstuale në të cilën zhvillohet njohuria muzikore.

Domosdoshmëria e zotërimit të kompetencave i aftëson individët/nxënësit/et të bëhen të aftë/a dhe t'i përdorin ato përgjatë gjithë jetës.

Kompetencat kyçe janë:

1. kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
2. kompetenca e të menduarit;
3. kompetenca e të mësuarit për të nxënë;
4. kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
5. kompetenca personale;
6. kompetenca qytetare;
7. kompetenca

Diagrami: **Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së muzikës për shkallën e tretë.**

**KOMPETENCAT KYÇE PËR T’U REALIZUAR NË MUZIKË
SHKALLA E TRETË
KLASA E GJASHTË DHE E SHTATË**

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi/ja:

- krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike;
- kupton drejt mesazhin artistik;
- demonstroi një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, të simboleve, të shenjave dhe të formave muzikore;
- shfrytëzon mjetet artistike, mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi/ja:

- kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur;
- zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike;
- zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese;
- ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim muzikor.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Nxënësi/ja:

- klasifikon mjetet për të realizuar një krijim muzikor;
- përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor;
- krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi/ja:

- ndërmerri nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.

Kompetenca personale

Nxënësi/ja:

- zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore;
- përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollë dhe komunitet;
- rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe krijimin e besimit te të tjerët.

Kompetenca qytetare

Nxënësi :

- bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;
- respekton punën e të tjerëve;
- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, brenda dhe jashtë shkollës.

Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:

- krijon informacion dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;
- njeh mjete të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

Programi i muzikës ka në thelbin e tij krijimin e kushteve për ndërtimin e **kompetencave të lëndës** si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. **Kompetencat kyçe**, në muzikë vendosen dhe zhvillohen sipas kontekstit të caktuar muzikor. Në shkallën e tretë në programin mësimor të muzikës, ato vijnë tashmë të ndërtuara edhe nga dy shkallët paraardhëse, I dhe II.

Çdo mësues/e duhet të dijë pse shërbejnë **7 kompetencat kyçe**, si t'i zhvillojë dhe t'i ndërtojë ato në kontekstin e lëndës së vet me nxënësit/et/et sipas formateve të përcaktuara. Këto kompetenca ndërtohen dhe arrihen përgjatë një shkalle të caktuar, në këtë rast, **kompetencat kyçe** të shkallës së tretë lidhen me klasën e gjashtë dhe të shtatë, të AMU-së. Mësues/ja duhet të kujdeset që përveç kompetencave lëndore të muzikës, të zhvillojë domosdoshmërisht me nxënësit/et e tij/saj edhe kompetencat kyçe.

2.2 Kuptimi dhe zbatimi i kompetencave lëndore dhe i tematikave që zhvillohen në lëndën e muzikës.

Qasja e bazuar në kompetenca është i gjithë procesi i të nxënit që zhvillohet në fushën e arteve në përgjithësi, në të gjitha shkallët, dhe që ndërtohet përmes kompetencave të kësaj fushe të **krijimit, të realizimit dhe vlerësimit**. Në të gjitha shkallët e kurrikulës, ato zhvillohen dhe plotësohen më tej me **rezultatet e të nxënit** brenda secilës fushe të arteve. Kompetencat lëndore të muzikës, lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me **kompetencat kyçe**. Këto kompetenca janë të lidhura ngushtë me tematikat e lëndës së muzikës dhe zhvillohen nëpërmjet tyre.

Përvetësimi i njohurive muzikore nënkupton **zotërimin e kompetencave muzikore**. Çka do të thotë, aftësi për të kuptuar, për të gjykuar dhe për të përdorur muzikën jo vetëm brenda kontekstit të programit mësimor dhe kërkesave të tij, por edhe në situata të shumëllojshme ku muzika luan ose mund të luajë një rol të rëndësishëm.

Me kurrikulën e re, muzika është strukturuar në **tri (3) tematika përmbajtjesore** dhe **tri (3) kompetenca**, të cilat listohen si më poshtë:

Tematikat që përshkojnë lëndën e muzikës

Mbi bazën e kësaj kurrikule, lënda e muzikës synon të përmbushë dhe të ndërtojë **tri kompetencat e lëndës muzikore**, të cilat zhvillojnë dhe ndërtojnë kompetencat kyçe që një nxënës/e duhet të zotërojë gjatë gjithë jetës. Ato realizohen nëpërmjet **tri tematikave kryesore** që përshkojnë gjithë lëndën e muzikës.

Tematikat përmbajtjesore, janë ato tematika që zhvillohen përgjatë programit, duke krijuar kushte që nxënësi/ja të ndërtojë dhe të zbatojë *njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat*, në funksion të **kompetencave të lëndës** dhe të **kompetencave kyçe**. Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë për klasën e shtatë. Përshkrimi i secilës **tematikë** dhe i **kompetencave lëndore** që duhet të demonstrojë nxënësi/ja në lidhje me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle.

TEMATIKAT E MUZIKËS ²	KOMPETENCAT E MUZIKËS
Tematika 1: Gjuha dhe komunikimi muzikor	Kompetenca 1: Krijimi muzikor
Tematika 2: Teknika dhe procese muzikore	Kompetenca 2: Interpretimi muzikor
Tematika 3: Historia, muzika dhe shoqëria	Kompetenca 3: Vlerësimi i veprave muzikore

Kompetenca 1: Krijimi muzikor, ka të bëjë me përdorimin e elementeve muzikore dhe zhvillimin e ideve të reja gjatë krijimit, me organizimin e krijimit sipas strukturës muzikore, si dhe me ndarjen e përvojave krijuese me të tjerët.

Kompetenca 2: Interpretimi muzikor, ka të bëjë me kuptimin dhe zbatimin e teknikave të këndimit, të interpretimit e të improvizimit deri në përsosjen e tyre si dhe me respektimin e rregullave të luajtjes në instrument dhe me ndarjen e përvojave interpretuese me të tjerët.

Kompetenca 3: Vlerësimi muzikor, ka të bëjë me kuptimin dhe analizimin e veprave muzikore që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik që i përgjigjet kësaj grupmoshe.

■ Tabela² e kompetencave lëndore të muzikës dhe përshkrimi i tyre.

Në krah të kompetencës lëndore është bërë përshkrimi i asaj çka duhet të realizojë nxënësi/ja për ndërtimin e secilës kompetencë muzikore.

Kompetencat muzikore	Përshkrimi i kompetencave lëndore
Krijimi muzikor	Nxënësi/ja: - përdor ide të ndryshme për të organizuar krijimin muzikor; - përdor elementet muzikore gjatë krijimit; - zhvillon ide të reja gjatë krijimit muzikor; - organizon krijimin e vet muzikor, sipas rregullave të strukturës së periudhës muzikore; - ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.
Interpretimi muzikor	Nxënësi/ja: - zhvillon teknikat e këndimit, të luajtjes, të dëgjimit, të analizimit e të improvizimit në nivele të ndryshme; - përsos këndimin duke zbatuar teknikat interpretimit muzikor; - respekton rregullat e luajtjes në instrumente; - ndan përvojat e veta interpretuese me të tjerë.

¹ Secila tematikë e lëndës së muzikës, duhet t'i realizojë të trija (3) kompetencat lëndore.

² Kjo tabelë është marrë nga programi mësimor i muzikës, klasa e shtatë, shkalla e tretë.

Vlerësimi i veprave muzikore	Nxënësi/ja: - analizon veprat muzikore që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë; - vlerëson veprat muzikore, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.
-------------------------------------	---

■ **Diagrami³: Kompetencat kyçe dhe lëndore, që formohen përmes tematikave përmbajtjesore të muzikës.**




³ Ky diagram është marrë nga programi mësimor i muzikës, klasa e shtatë, shkalla e tretë.

Nëse do të bënim një shpjegim të diagramit, vërejmë se *kompetencat kyçe* dhe *kompetencat lëndore* zhvillohen përmes *tematikave* të lëndës së muzikës, ku në qendër të mësimdhënies është nxënësi/ja.

2.4 Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare - diagrami⁴

Muzika është e lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikulë. Melodia, ritmi, harmonia, dinamika, tempi, forma muzikore, struktura e tyre etj., lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike brenda fushës së arteve si: kërcimin, artin pamor, teatrin, por edhe me fusha të tjera të nxëni brenda kurrikulës si: matematikën, gjuhën dhe komunikimin, shkencat shoqërore dhe mjedisi etj. Kështu mësuesit/et duhet t'u japin mundësinë nxënësve/eve të konsolidojnë dhe formojnë përvojat që ata/ato kanë krijuar, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm atyre. Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të muzikës me lëndë të tjera, të para përmes njohurive.



⁴ Ky diagram është marrë nga programi mësimor i muzikës, klasa e shtatë, shkalla e tretë.

II PLANIFIKIMI I KURRIKULËS

Planifikimi i kurrikulës dhe i përmbajtjes së programit përgjatë tremujorëve është një proces mjaft i rëndësishëm në punën e mësuesit/es që zgjat gjithë vitin shkollor dhe shoqërohet dhe me përgatitjen e dokumenteve përkatëse. Planifikimi këtyre dokumenteve të kurrikulës së re nga mësuesi/ja kërkon: liri, elasticitet dhe përgjegjshmëri në planifikim. Këto dokumente janë:

- 1) Planifikimi vjetor i lëndës Muzikë, sipas tremujorëve
- 2) Planifikimi tremujor (temat janë të ndërthura sipas tematikave)
- 3) Planifikimi ditor

Këto tri planifikime, bëhen duke u bazuar në ndarjen e kohës mësimore që sugjeron programi mësimor i muzikës që jepet në tabelën e mëposhtme:

■ **Tabela 1: Orë të sugjeruara për çdo tematikë**

Klasa e shtatë	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Teknika dhe procese	Historia, muzika dhe shoqëria	Gjithsej orë
	12	15	8	35 orë



■ Planifikimi vjetor i lëndës muzikë, sipas tematikave dhe tremujorëve

TEMATIKAT	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE		
	Shtator – Dhjetor 12 orë	Janar – Mars 12 orë	Prill – Qershor 11 orë
Gjuha dhe komunikimi muzikor (12 orë)	Rikujtojmë	Shkalla La minore	Korona dhe stakato
	Shkalla muzikore, Do +		
	Gradët e shkallës, toni dhe gjysmëtoni	Nota dhe pushimi 1/16	Koha 3/8 dhe 6/8
	Intervalet muzikore	Masa e paplotësuar	Shenjat e shartimit
	Akordi dhe arpezhi	Termet dinamikë	
Teknika dhe procese (15 orë)	Kënga “Gëzimi”	Luajmë me fyell ose tastierë, ushtrime në Do maxhor e La minor	Luajmë në fyell ose në tastierë, ushtrime me masën e paplotësuar
	Kënga “Gjuha jonë barot e trëndelinë”	Kënga “Ju fal këngën time”	Kënga “E thotë kënga çfarë ka zemra”
	Kënga “Dua më shumë Shqipërinë”	Kënga “Yellow Submarine”	Luajmë në fyell ose tastierë në kohën 3/8, 6/8
	Kënga “Malet me blerim mbuluar”	Luajmë në fyell ose tastierë, ushtrime me notën dhe pushimin 1/16	Kënga “Dhuratë për ditëlindje”
		Kënga “Eksploroj”	Luajmë në fyell ose në tastierë, ushtrime me koronën dhe stakaton
			Projekt kurrikular
Historia, muzika dhe shoqëria (8 orë)	Klasifikimi i zërave	Instrumentet me tastierë	Format e thjeshta muzikore
	Klasifikimi i instrumenteve muzikore	Formacionet instrumentale	Sonata
		Orkestrat simfonike	
	Karakteristikat e instrumenteve		
35 orë	12 orë	12 orë	11 orë

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi/ja:

1. krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike;
2. kupton drejt mesazhin artistik;
3. demonstroi një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave dhe formave muzikore;
4. shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi/ja:

1. kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur;
2. zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike;
3. zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese;
4. ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim muzikor.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Nxënësi/ja:

1. klasifikon mjetet për të realizuar një krijim muzikor;
2. përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor;
3. krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi/ja:

1. ndërmerri nisma për të zhvilluar veprimtari muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.

Kompetenca personale

Nxënësi/ja:

1. zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore;
2. përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe në komunitet;
3. rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe në krijimin e besimit të tjerët.

Kompetenca qytetare

1. Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.
2. Respekton punën e të tjerëve.
3. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, brenda dhe jashtë shkollës.

Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:

1. krijon informacion dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;
2. njeh/përdor mjete të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video, CD, DVD etj.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës		
Krijimi muzikor	Performimi/interpretimi muzikor	Vlerësimi muzikor
Nxënësi/ja: ♪ demonstroi kuptimin e shkallëve muzikore Do + dhe La -, akordi dhe arpezhi, T dhe 1/2 T; ♪ përdori simbole të ndryshme muzikore që ka mësuar, duke krijuar larmi në krijimin e vet; ♪ demonstroi kuptimin e shkallëve muzikore; ♪ komunikoi qartë njohuritë muzikore, lidhur me zërat vokale dhe instrumentet muzikore; ♪ provoi të këndojë fragmente të vogla muzikore për të kuptuar ndryshueshmërinë e vlerave të notave shumë të shkurtra; ♪ imitonte me zë ose fishkëllimë motive nga vepra të ndryshme muzikore.	Nxënësi/ja: ◆ demonstroi gjatë interpretimit të këngëve simbolet muzikore; ◆ luan apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara; ◆ këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; ◆ interpretoi këngët me ndjenjë dhe emocione; interpretoi këngët në ngjarjet e klasës apo të shkollës; ◆ interpretoi këngë të ndryshme me emocione; ◆ vlerësoi interpretimin e të tjerëve; ◆ përdori media (DVD, CD, magnetofon) për të paraqitur punën e vet; ◆ ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.	Nxënësi/ja: ☉ shpjegoi ndryshueshmërinë e muzikës gjatë respektimit të simboleve muzikore; ☉ bëri lidhje ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, instrumentet apo zërat vokale dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; ☉ bëri gjykime kritike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore si: <i>ndryshueshmëria e ritmeve muzikore, shpejtësia muzikore, zërat vokale dhe instrumentet muzikore</i>; ☉ komunikoi mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara; ☉ pasqyroi emocionet që i krijuan një vepër muzikore gjatë kohës që ajo interpretohet/luhet; ☉ shpreh mendimin e vet rreth pjesës muzikore që dëgjon; ☉ përdori një fjalor të thjeshtë muzikor; ☉ respektoi mendimin e shokëve/shoqeve; ☉ mori pjesë në veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.



■ Tremujori i parë Shtator – Dhjetor⁵, planifikimi i temave mësimore

NR.	TEMATIKA	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E PARASHIKUAR E TË NXËNIT	BURIMET
1.	Teknika dhe procese	Rikujtojmë	Provojmë njohuritë tona Improvizohet një konkurs ose kuic me pyetje të ndryshme rreth njohurive më të rëndësishme të muzikës nga klasa VI.	• teksti i nxënësit; • materiale ndërvepruese të përshtatura nga mësuesi/ja; • postera me tekstin e këngës dhe flamurin kombëtar, fotografi, CD.
2.	Historia, muzika dhe shoqëria	Klasifikimi i zërave	Kuici i këngëve sipas zërave të ndryshëm Nxënësit/et improvizojnë pasazhe të ndryshme këngësh sipas parapëlqimeve që ata/ato kanë dhe gjinisë që i përkasin për të bërë dallimin e ndryshimit të zërit të tyre djalë/vajzë.	• teksti i nxënësit; • burime tingullore të krijuar nga Nxënësit/et me gjini të ndryshme; • shembuj në CD.
3.	Teknika dhe procese	Kënga: “Ode gëzimi”	Ne dhe Evropa Nxënësit/et përcjellin emocionet e tyre për tekstin ku gjejnë mesazhin e bukur të lirisë.	• teksti i nxënësit; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; • materiale nga interneti rreth temës; • kënga në CD.
4.	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Shkalla muzikore, shkalla Do +	Loja e radhitjes së notave 8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 ku shkruhet me ngjyrë e notës përkatëse, vendosen sipas vendndodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës, ku secili/a lexon notën që mban në dorë: do, re, mi, fa, sol, la, si, do.	• teksti i nxënësit; • materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja; • këndimi i shkallës Do+ në ngjitje dhe zbritje në CD.

⁵ Të nderuar kolegë, përfundimi i tremujorit të parë llogaritet kur keni plotësuar 12 tema/javë mësimore.

5.	Teknika dhe procese	Kënga “Gjuha jonë barot e trëndelinë”	Muzika dhe fjala Nxënësit/et përcjellin emocionet e tyre për gjuhën shqipe, për poezi, tregime, drama, filma etj.	• teksti i nxënësit; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; • materiale nga interneti rreth temës; • kënga në CD.
6.	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Gradët e shkallës, toni dhe gjysmëtoni	Matematika dhe simbolet e saj < > Nxënësit/et shkruajnë një ekuacion matematikor kur përdorin shenjat < >. Ato kanë një kuptim në matematikë. Po në muzikë? Sa është largësia midis dy notave me T dhe 1/2 T?	• teksti i nxënësit/es; • libra të ndryshëm muzikorë; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
7.	Teknika dhe procese ⁸	Kënga “Dua më shumë Shqipërinë”	Pozita gjeografike, historike, kulturore, arsimore e krahinës/qytetit tim Nxënësit/et diskutojnë në klasë rreth qytetit dhe krahinës së tyre, duke renditur të gjitha karakteristikat kulturore, arkitektonike, arsimore, historike etj.	• teksti i nxënësit; • materiale nga enciklopedi të ndryshme; • materiale nga interneti për këngën e kultivuar; • kënga në CD.
8.	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Intervalet muzikore	Intervali kohor E ndeshim shpeshherë togfjalëshin “interval kohe” dhe me të, zakonisht, kuptojmë një hapësirë kohe që zë një punë e caktuar. Po në muzikë çdo të kuptojmë me <i>interval muzikor</i> ?	• teksti i nxënësit; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
9.	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Akordi dhe arpezhi	Gjejmë ndryshimet Nxënësit/et arrijnë të bëjnë këndimin e tri notave bashkë dhe veç e veç, duke kuptuar ndryshimet.	• teksti i nxënësit/es, libra të ndryshëm muzikorë; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
10.	Teknika dhe procese	Kënga “Malet me blerim mbuluar”	Lufta e dytë botërore Nxënësit/et gjejnë vetë informacione rreth Luftës së Dytë Botërore, ku një vend të veçantë zënë dhe këngët partizane.	• teksti i nxënësit; • materiale nga enciklopedi të ndryshme; • materiale nga interneti; • kënga në CD.

11.	Histori, muzika dhe shoqëria	Klasifikimi i instrumentave	Kuice dëgjimore Vendosen CD me fragmente muzikore që luhen me instrumente, të cilat nxënësit/et i identifikojnë. Ata/ato flasin rreth njohurive që kanë për këto lloj instrumentesh.	• teksti i nxënësit; • shembuj muzikorë në CD.
12.	<i>Teknika dhe procese</i>	Projekt kurrikular	Muzika dhe fëmijët Nxënësve/eve u kërkohet që të hartojnë së bashku pyetjet që do t'u bëhen të intervistuarve. Ata/ato kryejnë intervista në komunitet rreth llojit muzikor që pëlqejnë më shumë. Analizojnë me njëri/tjetrin përgjigjet e marra, duke përcaktuar muzikën e parapëlqyer (1 deri në 2 lloje të saj).	• teksti i nxënësit; • libra të ndryshëm muzikorë; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; • shembuj muzikorë dhe këngë në CD.
<i>Metodologjia</i> <i>Metoda ndërvepruese, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse.</i> - Puna në grup dhe puna individuale. - Hetimi dhe zbulimi. - Zbatime praktike brenda dhe jashtë klasës. Metoda ndërvepruese. - Bashkëbisedim. - Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues. - Paraqitje në forma të ndryshme, përfshirë TIK. - Projekte kurrikulare.				
Vlerësimi: - vlerësimi përshkrues; - vlerësimi i tematikave përmbyllëse; - vlerësimi i dosjes.				

⁶ Mund të përdoret nga mësuesit/et edhe si detyrë përmbyllëse për vlerësimin në fund të tremujorit.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

4. Metodologjia e të nxënit dhe e mësimeve bazuar në kompetenca për lëndën e muzikës

4.1. Planifikimi i situatave të të nxënit - Planifikimi ditor

Përdorimi i metodologjive të efektshme në procesin e të nxënit të muzikës është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve/eve, duke i dhënë secilit/ës mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor/artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të muzikës, do të thotë që nxënësit/et/et të vendosen në situata konkrete krijuese, ku ata/ato përjetojnë dhe provojnë vetë gjatë proceseve muzikore. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet motivimit dhe përkundrejt zhvillimit të kompetencave të caktuara si dhe të tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e muzikës, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari krijuese, shprehëse, emocionale. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore muzikore është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit/et drejtohen drejt saj në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit intelektual/krijues dhe artistik në shumë aspekte.

Ajo synon gjithëpërfshirjen dhe bazohet ***në mësimdhënien dhe nxënien e bazuar në kompetenca; mësimdhënien me në qendër nxënësin/en dhe mësimdhënien e nxënien e integruar.***

Nxënësit/et/et e një klase janë të ndryshëm/e, për sa i përket mënyrës se si ata/ato nxënë: *individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit/es, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.* Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e muzikës mban parasysh:

- ndërtimin e kompetencave kryesore të të nxënit në muzikë;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e njëkohshmërisë vertikale të njohurive e të aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin e aftësive dhe të shprehive muzikore;
- zbatimin e veprimtarive krijuese/interpretuese/vlerësuese muzikore, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet muzikore me situata të jetës reale;
- përdorimin e mjeteve muzikore konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë CD, DVD, kompjuter, magnetofon;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillimin e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së muzikës dhe vlerësimin e përdorimit të gjithanshëm të saj;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues/e-nxënës/e në mënyrë që ata/ato të jenë në mënyrë të ndërsjellë plotësues/e të njëri-tjetrit në procesin mësimor.

Një mësimdhënie e planifikuar mirë, krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit/es, ashtu edhe atë të nxënësit/es. Planifikimi i mirë i përmbajtjes dhe ndërtimi i kompetencave muzikore të përcaktuara në këtë program janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet *situatave të të nxënësit*. *Situata e të nxënësit* për secilin model të planifikimit ditor, është sugjeruese, sepse kërkon të nxisë dhe të orientojë mësuesit/et rreth zhvillimit të orës mësimore. Niveli i nxënësve/eve, burimet materiale, përvoja e vetë mësuesit/es, mjetet në dispozicion për realizimin e orës mësimore janë të ndryshme, dhe për këtë arsye edhe vendosja e rezultateve të të nxënësit për zhvillimin e kompetencave kyçe dhe lëndore nuk mund të jenë për të gjithë njësoj. Kështu që, çdo mësues/e mund të zgjedhë ta zhvillojë temën mësimore sipas modelit të sugjeruar ose sipas një situate tipike për klasën e tij/saj. Ato kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve/eve përmes njohurive që ata kanë. Nxënësit/et/et janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, në krijime ose në stimulime të njohurive, të interpretimeve, të gjykimeve dhe të qëndrimeve artistike. Për të siguruar pjesëmarrjen aktive të nxënësve/eve, mësuesi/ja duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në muzikë.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësit/et/et të punojnë në lidhje me situata dhe veprimtari reale që ata i njohin, ku u kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si: “Pse më pëlqen?”, “A është melodioze?”, “Cilat instrumente dëgjoj?”, “Pse shquhet ky kompozitor?”, “A kam dëgjuar më parë rreth saj” etj. Në këtë mënyrë ai nxitet të reflektojë mbi veprimet e veta dhe të zhvillojë situata të reja në kontekste të caktuara.

Projektet kurrikulare janë një tjetër mënyrë për t’i krijuar nxënësit/es mundësinë që të zbatojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron, dhe të krijojë lidhje integruese me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj. Edhe paraqitjet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë të mira për realizimin e kompetencave muzikore/artistike, dhe mbi të gjitha të kompetencave kyçe.



■ PLANIFIKIMI DITOR PËR TRE MUJORINË PARË: SHTATOR – DHJETOR

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: “Rikujtojmë”		Situata e të nxënit: Provojmë njohuritë tona Improvizohet një konkurs ose kuic me pyetje të ndryshme rreth njohurive më të rëndësishme të muzikës nga klasa VI që përfshijnë të tria tematikat.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - rikujton saktë dhe komunikon qartë njohuritë muzikore që zotëron; - plotëson saktë njohuritë e marra në fishat e përgatitura; - këndon duke respektuar rregullat e këndimit; - respekton interpretimin e shokëve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët, respekton këngë të kulturave të tjera.		 Fjalët kyçe: - njohuritë bazë të klasës VI (pentagrami, shenjat e ngjyrit, pika e vlerës, format muzikore, ritmet 2/4, 3/4, 4/4, etj.); - rregullat e këndimit; - këngë himn.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale ndërvepruese të përshtatura nga mësuesi/ja - rreth njohurive të marra në klasën VI; - postera me tekstin e këngës dhe flamurin kombëtar. - CD me këngë të ndryshme dhe Himnin Kombëtar.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore dhe mjedisi: historia; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia; - TIK. Lidhja me temat ndërkurrikulare: - - identiteti kombëtar.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari të llojit ndërveprues ku mësuesi/ja mund të përgatisë disa fisha të gatshme për rikujtimin e njohurive të marra në klasën VI. Kështu improvizohet një konkurs ose kuic me pyetje të ndryshme rreth njohurive më të rëndësishme të muzikës nga klasa VI ku përfshihen të tria tematikat p.sh.: bëhen pyetje rreth ritmeve të thjeshta ose vendosen a shfaqen me projektor kuice të ndryshme dhe nxënësit/et përgjigjen rreth pyetjeve që lexojnë. Ata/ato rikujtojnë dhe Himnin Kombëtar, çka u nxit dëshirën e bashkëbisedimit për identitetin e tyre dhe simbolet që përfaqësojnë kombin.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja krijon fisha pune të ndryshme për të nxitur nxënësit/et që të kujtojnë njohuritë e marra në klasën VI dhe këngët më të bukura. Ai/a jo i nxit që të flasin duke diskutuar rreth muzikës dhe asaj që do t’u pëlqente më shumë të mësonin këtë vit. Ata/ato përgjigjen me gojë, duke ndjekur në tabelë përmes projektorit pyetjet apo informacionet e kërkuara. Më pas ata këndojnë himnin në ritëm dhe intonacion vetëm ose në grup.			

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura në:*


- diskutimet që ai/ajo bën në lidhje me njohuritë muzikore;
- plotësimin saktë të kuiceve dhe të pyetjeve rreth njohurive muzikore;
- këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrave.

Detyrë: Fishat e plotësuar nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

- **Paraqiten** disa pyetje të shpejta në dërrasë me projektor ose shpërndahen fletë të parapërgatitura me pyetje rreth njohurive të klasës VI.

1. Çfarë është pentagrami? Sa çelësa muzikore janë?
2. Cilat janë notat në vija dhe në fusha, poshtë dhe sipër pentagramit?
3. Ndërto notat në vija dhe në fusha, poshtë dhe sipër pentagramit.



1. Të plotësojnë dhe të shkruajnë brenda figurës me ngjyrë vlerat e notave dhe të pushimeve. Nxënësit/et nxiten që të flasin ose të bashkëveprojnë për plotësimin e fishave/përgjigjeve.

Notë dhe pushim i plotë

- **Vendosen** për dëgjim disa minuta këngë të mësuara në klasë VI dhe nxiten nxënësit/et të flasin rreth *karakterit* dhe *shpejtësisë* në të cilën ato ekzekutohen.

- **Këndohet** kënga duke respektuar *ritmin*, *intonacionin*, dhe *interpretimin e saj me ndjenjë*.

**Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es**

Ai/ajo:

- krijon ushtrime në kohët e mësuara 2/4, 3/4, 4/4;
- punon dhe plotëson fishat;
- sjell histori, biografi rreth një kompozitori të parapëlqyer.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria Tema mësimore: “Klasifikimi i zërave”		Situata e të nxënësve: Kuici i këngëve sipas timbrikës së zërave të ndryshëm Nxënësit/et improvizojnë pasazhe të ndryshme këngësh sipas parapëlqimeve që kanë dhe gjinisë që i përkasin për të bërë dallimin e zërit djalë/vajzë.	
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - demonstroi kuptimin e zërave që dëgjon dhe i klasifikon ato; - provon të këndojë duke imituar fragmente të vogla muzikore për të kuptuar ndryshueshmërinë e zërave dhe karakteristikat që ato kanë në varësi të gjinisë (maskull – femër); - përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të paraqitur punën e vet; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.		 Fjalë kyçe: - zëra femërorë – llojet/klasifikimi; - zëra mashkullorë – llojet/klasifikimi; - zëra fëmijësh; - karakteristikat/cilësitë e tyre.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - shembuj në CD me fragmente vokale të kënduara nga burra, gra dhe fëmijë.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat e natyrës: • fizika (muzika dhe vala e zërit (frekuenca); • biologjia (ndërtimi i laringut).	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku nxënësit/et dalin në oborrin e shkollë dhe identifikojnë shumëllojshmëri zërash (të mësuesve/eve, shokëve dhe shoqeve, rojës së shkollës etj.) duke i emërtuar sipas karakteristikave që kanë. Ata/ato imitojnë pasazhe të ndryshme këngësh sipas parapëlqimeve që kanë dhe gjinisë që i përkasin për të bërë dallimin e zërit djalë/vajzë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, teksa mësuesi/ja vendos një poster dhe fillon të kërkojë nga nxënësit/et që përcaktojnë nëpërmjet njohurive që kanë laringun, pjesët e trupit ku formohet zëri i njeriut. Më pas vendos në CD disa fragmente muzikore ku nxënësit/et dallojnë llojet e zërave që dëgjojnë. Ata gjithashtu fillojnë të bëjnë krahasimin e cilësive të zërave që dëgjojnë duke i shënuar në fletore apo dërrasë të zezë. Nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, <i>YouTube</i> nxënësit/et sjellin këngë të parapëlqyera të bashkëmoshatarëve/eve të tyre dhe diskutojnë për karakteristikat që veçojnë në to dhe arsyet pse i pëlqejnë.			

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura në:*

- dëgjimin e fragmenteve muzikore vokale, duke bërë klasifikimin tyre;
- shpjegimin për ndjesinë që i jep timbri i zërave të ndryshëm të burrave, të grave, të fëmijëve, të të rinjve që i dëgjon të këndojnë.
- dallimin e pjesëve të ndryshme muzikore vokale dhe shpjegimin pse i pëlqejnë.
- gjetjen dhe krijimin e këngëve të kënduara nga këngëtarë të ndryshëm sipas klasifikimit të zërave që mësuuan, duke i sjellë në klasë me CD/DVD.
- në bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

- **Paraqitet** një poster me pjesën e sipërme të trupit, nga gjoksi e lart. Nxënësit/et gjejnë pjesët e mësuara ku formohet zëri, duke i përcaktuar dhe renditur ato në dërrasë.

🎵 **Dëgjojen** për disa minuta fragmente të kënduara nga këngëtarë/e të njohur/a shqiptarë/e dhe të huaj/e. Nxënësit/et gjejnë emrat e tyre, llojin e zërit dhe flasin rreth biografisë së tyre, nëse kanë informacion.

- **Shpërndahe** një fjalëkryq që të plotësohet nga nxënësit/et.

¹ F							
			² T				
	³ S						
⁴ K							
		⁵ M					
		⁶ M					

1. Zëra të bardhë quhen zërat e...
2. Zëri më i lartë te meshkujt quhet...
3. Zëri më i lartë te femrat quhet...
4. Kur këndojnë të gjithë së bashku quhet...
5. Emri i tij është... Xhemali.
6. Inva, mbiemri i saj është...

**Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es**


Ai/ajo:

krijon CD me fragmente të ndryshme operistike nga këngëtarë lirikë dhe këngëtarët e tij/saj të parapëlqyer;

- **zhvillon** një historik të shkurtër biografik rreth një këngëtari apo grupi të parapëlqyer;
- **krijon** një album me fotografi të këngëtarëve/e lirikë/e, të muzikës popullore e asaj të lehtë, duke përcaktuar karakteristika të zërave të tyre.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: “Ode gëzimi” (nga simfonia e IX e Bethovenit)		Situata e të nxënit: Ne dhe muzika Nxënësit/et përcjellin emocionet e tyre për tekstin e këngës dhe melodinë e saj, ku gjejnë mesazhin e bukur të lirisë.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët, respekton këngë të kulturave të tjera.		 Fjalë kyçe: - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - materiale nga interneti; - kënga në CD.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore dhe mjedisi: historia; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku nxënësit/et gjejnë himne të shteteve të tjera dhe i vërshtëllejnë ose i këndojnë ato.			
Ndërtimi i njohurive të reja Ora mësimore vazhdon më tej, duke dëgjuar bazën muzikore të himnit evropian. Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të flasin mbi të dhe të komentojnë me njëri-tjetrin vargjet e këngës. Mësuesi/ja ua mëson këngën në vargje, në strofë dhe në fund e përsërisin disa herë, deri në përvetësimin e mirë të saj.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re; - këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit; - interpretimin e këngës me emocion; - në bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës); - në këndimin korrekt në ritëm dhe intonacion. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			


Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



• **Vazhdohet** puna me mësimin e këngës sipas hapave të mëposhtëm:

- ☐ këndohet kënga varg pas vargu;
- ☐ përsëriten e vargjet herë pas here;
- ☐ këndohet strofa;
- ☐ këndohet strofa dhe refreni;
- ☐ përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- ☐ interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- ☐ këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.*



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



- **gjen** këngë të tjera të krijuara nga kompozitori Bethoveni;
- **gjen** informacion për jetën dhe veprën e Bethovenit;
- **krijon** një ese në lidhje me dashurinë dhe mesazhin që jep kënga.

Shënime specifike:



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Shkalla muzikore Do maxhore”		Situata e të nxënit: Loja e radhitjes së notave 8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 ku shkruhet me ngjyrë nota përkatëse. Ata/ato vendosen sipas vendndodhjes së notës nëpentagramin e vizatuar në dyshtemenë e klasës dhe secili/a lexon notën që mban në dorë: Do, Re, Mi, Fa, Sol, La, Si, Do.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - demonstron kuptimin e shkallës muzikore; - ndërton shkallën Do+ në ngjitje dhe në zbritje; - komunikon qartë njohuritë muzikore mbi shkallën muzikore; - këndon saktë nga ana intonacionit shkallën Do+ në ngjitje dhe zbritje; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.		☒ Fjalë kyçe: - shkalla muzikore; - shkalla Do+.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja; - shkalla Do+ në ngjitje dhe zbritje në CD.			
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja përzgjedh 8 nxënës/e që mbajnë në duar nga një fletë A4 ku shkruhen me ngjyrë notat: Do, Re, Mi, Fa, Sol, La, Si, Do. Ata/ato vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshtemenë e klasës, dhe secili lexon notën që mban në dorë: Do, Re, Mi, Fa, Sol, La, Si, Do.			
Ndërtimi i njohurive të reja Ora mësimore vazhdon më tej, teksa nxënësit/et kuptojnë se nga vendndodhja e notave ata/ato vijnë duke u ngjitur në pentagram njëri pas tjetrit. Kështu ata/ato arrijnë në përfundimin se shkalla është renditja graduale e 8 notave muzikore të vendosura njëra pas tjetres ku secila prej tyre ka një lartësi të caktuar. Ata/ato lexojnë shkallën dhe më pas fillojnë ta këndojnë atë disa herë.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në: - diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj mbi shkallën muzikore; - ndërtimin e shkallës Do+ dhe kuptimin e saj; - këndimin korrekt të shkallës në intonacion në ngjitje dhe në zbritje; - bashkëpunimin dhe këndimin në grup të shkallës. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimimit



Ushtrime dhe lojëra argëtuese


Dëgjohet një pasazh muzikor ku nxënësit/et dëgjojnë disa nota që ngjiten dhe zbresin. Ky është edhe çelësi që ata/ato duhet të gjejnë pasi kanë dëgjuar pasazhin.

• **Në vijim** u kërkohet nxënësve/eve të shprehin me fjalët e tyre çfarë dëgjuan.

1. Plotëso saktë përkufizimet:

- Shkallë muzikore quhet _____.
- Shkallët ndahen në 2 lloje: shkallë _____+ dhe shkallë _____-.
- Toni është _____.
- Gjysmëtoni është largësia _____.
- Shkallë Do+ quajmë renditjen graduale të 8 notave që fillon me _____ dhe mbaron me _____.
- Shkalla Do+ ka 5 tone dhe gjysëmtonet. Gjysëmtonet janë në notat dhe _____.
- Gradët e shkallës shkruhen me shifra romake ose me _____.

2. Lidh me shigjetë notat mbi tastierë, me notat e shpërndara në pentagram.




Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

Ai/ajo:

- krijon** një ushtrim në kohën 3/4 me 8 masa nga nota Do në notën Do².

Shënime specifike:



Fusha: Arte		Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: Kënga “Gjuha jonë barot e trëndelinë”			Situata e të nxënit: Muzika dhe fjala Nxënësit/et përcjellin emocionet e tyre në mënyra të ndryshme përmes gjuhës, poezisë, tregimit, dramës, filmit, muzikës etj.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët, respekton këngë të kulturave të tjera.			 Fjalë kyçe: - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - materiale nga interneti rreth temës; - kënga në CD.			Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore dhe mjedisi: historia; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve				
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos dy simbole ose fotografi/postera të ndryshëm: <i>fjalë të ndryshme dhe nota muzikore.</i> Nxënësve/eve u kërkohet që të flasin për emocionet që përcjellin arti i <i>fjalës</i> dhe i <i>muzikës</i> . Diskutimet ndihmojnë që ata/ato të kuptojnë vetë se sa e rëndësishme është gjuha në jetën tonë të përditshme.				
Ndërtimi i njohurive të reja Ora mësimore vazhdon më tej, teksa nxënësi/ja fillon të mësojë hap pas hapi vijën melodike të këngës. Pasi e kanë mësuar të gjithë këngën, nxënësit/et e përsërisin disa herë atë, duke respektuar ritmin, intonacionin si dhe rregullat e këndimit, vetëm dhe në grup. Ata vazhdojnë ta përsëritin këngën disa herë.				
Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në: - diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re; - këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit; - interpretimin e këngës me emocion; - bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës); - këndimin korrekt në ritëm dhe në intonacion. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.				

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

 **Dëgjohet** kënga “Gjuha jonë barot e trëndelinë” një herë me tekst dhe një herë pa tekst. Nxënësit nxiten që të flasin, duke u shprehur nëse kënga do të ishte më e bukur dhe do të krijonte emocion vetëm përmes muzikës apo përmes të dyjave së bashku.

• **Vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



Ai/ajo:

- **gjen** këngë të tjera të krijuara nga kompozitori L. Dizdari;
- **gjen** disa poezi që i kushtohen gjuhës shqipe;
- **krijon** një ese në lidhje me dashurinë dhe respektin që duhet të kemi ndaj gjuhës sonë.

Shënime specifike:




Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Gradët e shkallës, toni dhe gjysmëtoni”		Situata e të nxënësve: Matematika dhe simbolet e saj < > Vetë nxënësit/et shkruajnë një ekuacion matematikor, teksa përdorin shenjat < >. Këto shenja kanë një kuptim në matematikë. Në muzikë tregojnë se sa është largësia midis dy notave me T dhe ½ T.	
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor simbolet matematikore në funksion të ndërtimit të shkallës muzikore; - demonstroi kuptimin e tyre gjatë shpjegimit të krijimit të vet; - shpjegon ndryshueshmërinë dhe funksionin e T nga 1/2 T në ndërtimin e shkallëve muzikore; - këndon gradët e shkallës në ngjitje dhe në zbritje		 Fjalë kyçe: - gradët e shkallës; - toni; - 1/2 toni.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - libra të ndryshëm muzikorë; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD me shembuj konkretë.		Lidhja me fushat e tjera: - matematika	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja u vendos disa numra dhe simbole mjaft të njohura për nxënësit/et që përdoren në matematikë I, II, III, IV etj., si dhe < > dhe i nxit që të diskutojnë dhe të nxjerrin kuptimin që kanë ato. Çfarë roli dhe funksioni mund të luajnë edhe në muzikë?			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja vazhdon më tej veprimtarinë, duke vendosur një CD me shembuj të renditjes graduale të notave në mënyrë kromatike, duke u kërkuar nxënësve/eve të thonë çfarë dëgjojnë. Më pas ndërton shkallën DO+ në dërrasë dhe shpjegon kuptimin e gradëve në muzikë dhe T dhe 1/2 tonit. Gjatë ndërtimit të shkallës dhe vendosjes së gradëve dhe T e 1/2 T shkalla do të marrë formën e saj të plotë me të gjitha elementet e saj. Nxënësit/et punojnë sërish në fletoren e tyre, shkallën muzikore DO+, por tashmë të plotësuar me të gjitha elementet përkatëse.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në: - kuptimin e funksionimit të vendosjes së gradëve T dhe 1/2 T gjatë ndërtimit të një shkalle muzikore; - ndërtimin e shkallës DO+ të plotë; - këndimin në shkallën DO+ të plotë, vetëm ose në grup.			
- Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimimit



Ushtrime dhe lojëra argëtuese

- Nxënësve/eve u kërkohet të gjejnë ndryshimet në tastierën e mëposhtme dhe t'i thonë ato me njëri-tjetrin.




Dëgjohet një pasazh muzikor ku nxënësit/et dëgjojnë disa nota që ngjiten dhe zbesin, dhe veçojnë tingujt shumë të afërt prej 1/2 toni që dëgjojnë. Ata/ato diskutojnë për fenomenin muzikor që dëgjojnë.

- Në vijim** u kërkohet nxënësve/eve të shprehin me fjalët e tyre çfarë dëgjuan. Ky është edhe çelësi që ata duhet të gjejnë pasi kanë dëgjuar pasazhin.

1. Plotëso saktë përkufizimin:

- Gradat e shkallës shkruhen me shifra romake ose me _____.

2. Ndërto shkallën Do+ në ngjitje dhe në zbritje.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

Ai/ajo:

- krijon një ushtrim ku përdoren notat e shkallës Do maxhore** në kohën 2/4 me 16 masa.

Shënime specifike:



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: Kënga “Dua më shumë Shqipërinë”		Situata e të nxënësve: Pozita gjeografike, historike, kulturore, arsimore e krahinës/qytetit tim Nxënësit/et diskutojnë në klasë rreth qytetit dhe krahinës së tyre, duke renditur të gjitha karakteristikat kulturore, arkitektonike, arsimore, historike etj.	
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - komunikon qartë informacionin që ka për krahinën/qytetin e vet; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.		 Fjalë kyçe: - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale nga enciklopedi të ndryshme; - materiale të parapërgatitura nga mësuesi/ja për qytetin/krahinën; - kënga në CD.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore: historia; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia. Lidhja me temat ndërkurrikulare - trashëgimia kulturore.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja vendos në magnetofon këngën “Dua më shumë Shqipërinë” dhe i nxit nxënësit/et të diskutojnë në klasë rreth qytetit dhe krahinës së tyre, duke renditur të gjitha karakteristikat kulturore, arkitektonike, arsimore, historike etj.			
Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit/et kuptojnë rëndësinë e personifikimit të vendit të tyre në këngë, poezi, fakte historike etj., dhe përfaqësimit të tyre kudo si pjesë e identitetit kombëtar. Mësuesi/ja u mëson nxënësve/eve këngën në grup, duke respektuar karakteristikat e saj. Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, vetëm dhe në grup.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në: - diskutim me të tjerët rreth karakteristikave të qytetit dhe krahinës së tyre; - këndim duke interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe në intonacion; - interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion vetëm dhe në grup. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et (ese/filmime/histori rreth temës) ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Dëgjohet kënga “Dua më shumë Shqipërinë”.

- Nxënësit/et **nxiten** që të flasin, duke u shprehur pse u pëlqen kënga dhe se çfarë do të thotë për ta: “dua më shumë Shqipërinë”.
- **Vazhdohet** puna me mësimin e këngës, sipas hapave të mëposhtëm:
 - o këndohet kënga varg pas vargu;
 - o përsëriten vargjet herë pas here;
 - o këndohet strofa;
 - o këndohet strofa dhe refreni;
 - o përsëritet kënga nga fillimi në fund;
 - o interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
 - o këndohet kënga vetëm dhe në grup.
- **Gjatë mësimin të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



Ai/ajo:

- **gjen** informacion nga burime të ndryshme për grupin “Lira” dhe diskuton për atë me të tjerët në klasë.
- **përshekruan** emocionet që i krijohen nga kjo këngë përmes një eseje të shkurtër.

Shënime specifike:



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Intervalet muzikore”		Situata e të nxënësve: Intervali kohor E ndeshim shpeshherë togfjalëshin “interval kohe” dhe me të, zakonisht, kuptojmë një hapësirë kohe që zë një punë e caktuar. Po në muzikë çdo të kuptojmë me <i>interval muzikor</i> ?	
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - demonstroi kuptimin e intervaleve muzikore; - ndërton intervalet nga nota të ndryshme muzikore; - shpjegon ndërtimin e tyre, duke respektuar edhe punën e shokëve/shoqeve.		 Fjalë kyçe: - interval muzikor: <i>prima, sekonda, terca, kuarta, quinta, seksta, septima, oktava</i>.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD me shembuj muzikorë.		Lidhja me fushat e tjera: - gjuha dhe komunikimi: gjuha italiane.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete, e cila e ndihmon mësuesin/en për shpjegimin e togfjalëshit “interval kohe”, me të cilin kuptojmë një hapësirë kohe që zë një punë e caktuar. Ai/ajo u kërkon nxënësve/eve që të numërojnë nga 1-8 në italisht (kush di). Po në muzikë çdo të kuptojmë me <i>interval muzikor</i> ?			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja vazhdon më tej veprimtarinë, duke shkruar me kujdes 8 notat muzikore dhe duke rikujtuar edhe T dhe 1/2 T, të cilat do të ndihmojnë për kuptimin më mirë të intervaleve muzikore. Pas vendosjes së 8 notave muzikore, mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve që të gjejnë T dhe 1/2 T dhe pastaj vendos për secilin interval emrin e tij, duke shpjeguar pse quhet i tillë. Më pas shpjegohet roli dhe funksioni që luajnë në muzikë <i>intervalet muzikore</i> . Nxënësit/et punojnë intervalet në fletoren e tyre, duke plotësuar krijimin me të gjitha elementet përkatëse.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në: - kuptimin e funksionimit të intervaleve muzikore në muzikë; - krijimin e intervaleve të ndryshme nga nota të ndryshme muzikore; - shpjegimin e qartë të krijimit të tyre. - Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimimit



Ushtrime dhe lojëra argëtuese



U kërkohet nxënësve/eve të dëgjojnë intervalet muzikore, duke i emërtuar ato.

Prima

Sekonda

Terca

Kuarta

Kuinta

Seksta

Septima

Oktava

1. Ndërto intervalet e mëposhtme nga notat e dhëna:

Kuinta	Sekonda	Kuarta	Terca	Oktava	Prima	Septima
Do- Sol	Do-	Do-	Do-	Do-	Do-	Do-
Re-	Re-	Re-	Re-	Re-	Re-	Re-
Fa-	Fa-	Fa-	Fa-	Fa-	Fa-	Fa-
Sol-	Sol-	Sol-	Sol-	Sol-	Sol-	Sol-

2. Përcakto intervalet në ushtrimet e mëposhtme.

a. Allegretto




Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

Ai/ajo:

- krijon intervale të ndryshme muzikore nga notat: Do, Re, Mi, Sol, La.

Shënime specifike:



Fusha: Arte		Lënda: Muzikë		Shkalla: III		Klasa: VII	
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor				Situata e të nxënësve: Gjejmë ndryshimet			
Tema mësimore: “Akordi dhe arpezhi”				Nxënës/et arrijnë të bëjnë këndimin e tri notave bashkë njëherësh (3 nxënës/e) dhe pastaj veç e veç, për të kuptuar kështu ndryshimet.			
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore				 Fjalë kyçe:			
Nxënës/ja:				- akordi;			
- këndon tri nota njëzëri me të tjerët, duke kuptuar harmoninë që krijohet;				- arpezhi.			
- këndon tri nota njëra pas tjetërs dhe kupton ndryshimin;							
- ndërton akordin dhe arpezhin e shkallës Do+;							
- i shpjegon qartë ato.							
 Burimet:							
- teksti i nxënës/it;							
- libra të ndryshëm muzikorë;							
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.							
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve							
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve							
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të këndojnë tri nota bashkë njëherësh (3 nxënës/e) dhe pastaj veç e veç, për të kuptuar kështu ndryshimet. Mësuesi/ja mund të luajë edhe në tastierë 3 nota njëherësh dhe më pas veç e veç, që nxënës/et të kuptojnë më mirë harmoninë që krijohet nga bashkëtingëllimi i njëhershëm i tri notave muzikore.							
Ndërtimi i njohurive të reja							
Mësuesi/ja vazhdon më tej veprimtarinë, duke ndërtuar në dërrasë të zezë <i>akordin dhe arpezhin</i> e shkallës Do+ : Do, Mi, Sol njëra mbi tjetrën dhe Do, Mi, Sol njëra pas tjetrës. Mësuesi/ja i ndan nxënës/et në 3 grupe dhe i intonon të këndojnë akordin dhe arpezhin .							
Nxënës/et këndojnë akordin dhe arpezhin e shkallës Do+ disa herë deri në ngulitjen e saktë të intonacionit.							
Vlerësimi							
Vlerësimi i nxënës/it do të bëhet për rezultatet e arritura në:							
- këndimin e <i>akordit dhe të arpezhit</i> të ndarë në grupe;							
- shkrimin e <i>akordit dhe të arpezhit</i> të shkallës Do+ dhe të notave të tjera.							
- Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënës/et, ruhen në dosjet e tyre personale.							


Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimimit




Ushtrime dhe lojëra argëtuese

- Nxënësit/et **ndahen** në tri grupe dhe këndojnë tri nota Do – Mi – Sol njëherësh bashkë, dhe veç e veç.
- Mësuesi/ja **u kërkon** nxënësve/eve që të diskutojnë mbi ndryshimet gjatë këndimit.


1. **Shkruaj** akordin dhe arpezhin me notat Do, Re, Fa, Sol, Si.



2. **Shkruaj** emrat e notave që përbëjnë akordet e mëposhtme:



3. **Shkruaj** emrat e notave që përbëjnë arpezhet e mëposhtme:




Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

Ai/ajo:

- shkruan** akordin dhe arpezhin me notat Do, Mi, La, Sol, Si.

Shënime specifike:



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: Kënga “Malet me blerim mbuluar”		Situata e të nxënësve: Lufta e Dytë Botërore Nxënësit/et gjejnë informacione rreth Luftës së Dytë Botërore, ku këngët partizane zënë një vend të veçantë.	
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - komunikon qartë informacionin që ka për këngët partizane; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të saj; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.		 Fjalë kyçe: - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale nga enciklopedi të ndryshme; - materiale të parapërgatitura nga mësuesi/ja për këngën partizane; - kënga në CD.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore: historia; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia. Lidhja me temat ndërkurrikulare: - paqja dhe të drejtat e njeriut.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësues/ei/ja vendos në magnetofon këngën “Malet me blerim mbuluar” dhe i nxit nxënësit/et të diskutojnë në klasë rreth këngëve patriotike dhe partizane që dinë dhe t’i rendisin ato.			
Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit/et dëgjojnë këngën në CD ose të kënduar nga mësuesi/ja dhe fillojnë mësimin e saj. Mësuesi/ja u mëson nxënësve/eve këngën në grup, duke respektuar karakteristikat e këtyre këngëve të tipit marsh. Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe të këndimit në grup.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - diskutim me të tjerët rreth këngëve partizane; - këndimin e këngës, duke e interpretuar atë me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe në intonacion; - interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion, vetëm dhe në grup. - Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et (ese/filmime/histori rreth temës) ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

Dëgjohet kënga “Malet me blerim mbuluar”.

- Nxënësit/et **nxiten që** të flasin, duke thënë nëse u pëlqejnë dhe u krijojnë emocione këngët marsh ose jo.
- **Vazhdohet** puna me mësimin e këngës, sipas hapave të mëposhtëm:
 - o këndohet kënga varg pas vargu;
 - o përsëriten vargjet herë pas here;
 - o këndohet strofa;
 - o këndohet strofa dhe refreni;
 - o përsëritet kënga nga fillimi në fund;
 - o interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
 - o këndohet kënga, vetëm dhe në grup.

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit marsh, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.*



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

Ai/ajo:



gjen informacion nga burime të ndryshme për kompozitorin Dhora Leka;

- **përshekruan** një ngjarje ose një film shqiptar që trajton periudhën e luftës nacional-çlirimtare.

Shënime specifike:



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria Tema: “Klasifikimi i instrumenteve muzikore”		Situata e të nxënësve: Kuice dëgjimore Vendosen CD me fragmente muzikore që luhen me instrumente, të cilat nxënësit/et i identifikojnë. Ata/ato flasin rreth njohurive që kanë për këto lloj instrumentesh.	
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore - Nxënësi/ja: - dëgjon në CD dhe identifikon përmes timbrit instrumentet muzikore; - klasifikon instrumentet muzikore sipas materialit dhe ndërtimit që kanë; - shfaq parapëlqimin e vet për instrumentin që i pëlqen më shumë, duke sjellë shembuj të ndryshëm; - respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve.		 Fjalë kyçe: - instrumente muzikore; - klasifikim; - përbërje e materialit të instrumentit; - ndërtim i instrumentit.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale nga interneti; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD, fragmente të ndryshme muzikore.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore dhe mjedisit: historia dhe gjeografia; - gjuha dhe komunikimi. Lidhja me temat ndërkurrikulare: - të njohim kulturën e njëri-tjetrit.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku zhvillohet një kuic i shkurtër, përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, gjatë 20-30 sekondave. Vendosen CD me fragmente muzikore që luhen me instrumente, të cilat nxënësit/et i identifikojnë. Ata/ato flasin rreth njohurive që kanë për këto lloj instrumentesh.			
Ndërtimi i njohurive të reja Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, teksa mësuesi/ja paraqet lloje të ndryshme instrumentesh muzikore, nëpërmjet një posteri ose një projektori dhe u kërkon nxënësve/eve t'i identifikojnë ato sipas njohurive që kanë. Më pas, vendos CD me fragmente muzikore dhe nxënësit/et dallojnë instrumentet që dëgjojnë (piano, violinë, klarinetë, timpan). Ata/ato bëjnë gjithashtu krahasimin e cilësive të timbrit të instrumenteve që dëgjojnë, duke gjetur arsyen pse ndryshojnë prej njëri-tjetrit (përbërja dhe ndërtimi i tyre). Të gjitha arsyet i shënojnë në fletore ose në dërrasë të zezë. Nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, <i>YouTube</i> , nxënësit/et sjellin kuriozitete rreth krijimit dhe evoluimit të instrumenteve muzikore dhe i diskutojnë ato me shokët/shoqet.			

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në:


- dëgjimin e fragmenteve muzikore instrumentale, duke bërë klasifikimin e instrumenteve muzikore;
- shpjegimin e timbrit të tingullit që lëshon instrumenti, sipas përbërjes dhe ndërtimit të tij;
- dallimin e pjesëve të ndryshme muzikore instrumentale, ku shpjegon pse i pëlqen një instrument i caktuar;
- gjetjen dhe prurjen në klasë me CD/DVD të pjesëve instrumentale, sipas klasifikimit të instrumenteve të parapëlqyera;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

- **Detyra:** Punët dhe detyrat e zhvilluara nga vetë nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit**Ushtrime dhe lojëra argëtuese**

 **Vendosen** për dëgjim CD me fragmente muzikore që luhen me instrumente, të cilat nxënësit/et i identifikojnë. Ata/ato flasin rreth njohurive që kanë për këto lloj instrumentesh.

1. Lidh figurën që shikon me emrin e instrumentit.



saksofoni timpani violina klaviçembal organo elektrike tromboni kitara
elektrike ksilofoni harpa klarineta

- **Flit** për instrumentin muzikor që të pëlqen më shumë. Mundohu të imitosh me zë ose fishkëllimë ndonjë pjesë të luajtur me të.

**Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es**

Ai/ajo:

- **gjen** në internet kuriozitete për krijimin e instrumenteve të ndryshme muzikore.
- **kërkon** në internet rreth jetës së Stradivarit.

Shënime specifike:

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Projekt kurrikular: “Muzika dhe fëmijët”		Situata e të nxënit: Muzika dhe fëmijët Nxënësve/eve u kërkohet që të hartojnë së bashku pyetjet që do t’u bëhen të intervistuarve. Ata/ato kryejnë intervista në komunitet rreth llojit muzikor që pëlqehet më shumë. Përgjigjet që marrin i analizojnë me shokët/qet dhe përcaktojnë kështu muzikën e parapëlqyer (1 deri në 2 lloje).	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - harton në bashkëpunim pyetjet e intervistës, duke krijuar qartësi në atë çka kërkohet; - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - interpreton këngët në ngjarjet e klasës apo të shkollës; - interpreton këngë të ndryshme me emocion; - vlerëson interpretimin e të tjerëve; - respekton mendimin e shokëve/shoqeve; - merr pjesë në veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës; - përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; - përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të paraqitur punën e vet.		Fjalë kyçe: - intervistë; - komunitet; - muzikë e parapëlqyer.	
Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale nga interneti; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD, fragmente të ndryshme muzikore.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore dhe mjedisi: historia dhe gjeografia; - artet: kërcimi; - gjuha dhe komunikimi. Lidhja me temat ndërkurrikulare: - të njohim kulturën e njëri-tjetrit.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Ndarja e grupeve dhe ndarja e detyrave Mësuesi/ja bën paraqitjen e temës që në fillim të orëve të para: Muzika dhe të rinjtë. Më pas jep çështjet, të cilat nxënësit/et do t’i zhvillojnë në grupe të veçanta, ku secili/a mund të zhvillojë aftësitë më të mira që ka.			
Grupi intervistave 1. Harton pyetjet që do t’u bëhen të intervistuarve. 2. Kryen intervista në komunitet rreth llojit muzikor që pëlqehet më shumë. 3. Analizon përgjigjet që merren, duke përcaktuar muzikën (1 deri në 2 lloje) e parapëlqyer.			



- Grupet punojnë secili në mënyrë të pavarur, duke i zgjedhur vetë materialet dhe mjetet për të realizuar detyrën e ngarkuar.
Nxënësit/et vlerësojnë vetë punën e arritur nga secili grup.
Grupet e nxënësve/eve i paraqesin produktet e realizuara në fund të tremujorit.

- pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë krijimit muzikor dhe çështje të tjera lidhur me projektin.




Verifiko njohuritë e tua muzikore


1. Plotëso saktë përkufizimet.

- Shkallë Do+ quajmë renditjen graduale të 8 notave, që fillon me dhe mbaron me
- Shkalla La minore gjendet duke
- Shkallët janë dy llojesh: shkallë + dhe shkallë -.
- Toni është largësia
- Gjysmëtoni është largësia
- Arpezh quajmë gradëve kryesore të shkallës.
- Akord quajmë të gradëve kryesore të shkallës.

2. Ndërto shkallën Do+ dhe La- me akordet dhe arpezhet e tyre.



3. Lidh me shigjetë notat me emërtimin e intervalit.



do – la	oktava
do – sol	prima
do – re	terca
do – si	seksta
do – do ²	septima
do – fa	kuarta
do – mi	sekonda
do – do	kuinta

4. Rretho përgjigjen e saktë.

► Kënga himn këndohet në:

- a) takime ku përfaqësohet vendi; b) ditëlindje; c) piknik.

► Kënga partizane është kënduar në:

- a) dasma; b) festa; c) Luftën e Dytë Botërore.

► Kënga patriotike është kënduar në:

- a) fillim të shek. XX; b) festa muzikore; c) festivale.

5. Plotëso vendet bosh.

► **Zëra femërorë**, nga zëri më i lartë deri te më i ulëti.

..... → *më i larti nga të gjithë zërat.*

..... → *më i ulët se zëri i sopranos.*

..... → *më i ulëti nga zërat femërorë.*

► **Zëra mashkullorë**, nga zëri më i lartë deri te më i ulëti

..... → *më i larti nga zërat mashkullorë.*

..... → *më i ulët se zëri i tenorit.*

..... → *më i ulëti nga të gjithë zërat.*

► **Zërat e fëmijëve** janë zëra

6. Plotëso vendet bosh.

● Instrumentet muzikore ndahen në 4 grupe. Ato janë:

a) Grupi i instrumenteve


b) Grupi i instrumenteve

c) Grupi i instrumenteve

d) Grupi i instrumenteve

7. Nëse do të përshkruaje emocionet e këngës, çfarë do të përdorje: fjalët, ngjyrat, vallëzimin apo...?

■ Përdor njëren prej tyre për të shprehur emocionet e këngës së mësuar.



REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi/ja:

1. krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike;
2. kupton drejt mesazhin artistik;
3. demonstroi një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave dhe formave muzikore;
4. shfrytëzon mjetet artistike, mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi/ja:

1. kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur;
2. zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike;
3. zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese;
4. ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim muzikor.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Nxënësi/ja:

1. klasifikon mjetet për të realizuar një krijim muzikor;
2. përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor;
3. krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi/ja:

1. ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.

Kompetenca personale

Nxënësi/ja:

1. zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore;
2. përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;
3. rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe në krijimin e besimit te të tjerët.

Kompetenca qytetare

Nxënësi/ja:

1. bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;
2. respekton punën e të tjerëve;
3. bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht kulturës, brenda dhe jashtë shkollës.

Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:


1. krijon informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;
2. njeh mjetet e ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video, CD, DVD etj.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës		
Krijimi muzikor	Interpretimi muzikor	Vlerësimi muzikor
Nxënësi/ja: ♫ krijon duke përdorur kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh shumë të shkurtra (1/16); ♫ demonstroi kuptimin e tyre gjatë shpjegimit të krijimit të vet muzikor; ♫ komunikoi qartë njohuritë muzikore mbi termat muzikore dhe kuptimin që i japin ato muzikës, duke i lidhur me emocionet e këngëve që këndon; ♫ provon të këndojë fragmente të vogla muzikore për të kuptuar ndryshueshmërinë e muzikës përmes zbatimit të vlerave të notave dhe të ritmeve të mësuara, të termave dinamikë, të shenjave të shartimit. 	Nxënësi/ja: ♦ demonstroi gjatë interpretimit të këngëve simbolet muzikore (termat dinamikë); ♦ luan në instrument ose këndon duke respektuar simbolikat e mësuara; ♦ këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; ♦ interpretoi këngët me ndjenjë dhe emocion; ♦ interpretoi këngët në ngjarje të klasës apo të shkollës; ♦ përdori media (DVD, CD, magnetofon) për të paraqitur punën e vet.  	Nxënësi/ja: ☺ shpjegon ☺ shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë respektimit të simboleve; ☺ shpreh emocionet e veta për këngët që këndon; ☺ përdor një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, gjatë përjetimit emocional të pjesëve muzikore që dëgjon; ☺ ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; ☺ respekton këngët e kulturave të tjera; ☺ bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, instrumentet apo vokalën dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; ☺ bën gjykime kritike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore, rreth formacioneve të ndryshme orkestrale, orkestrave simfonike; ☺ komunikoi mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëguara; ☺ reflektoi emocionet që i krijon një vepër muzikore gjatë kohës që interpretohet/luhet; ☺ përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; ☺ respekton mendimin e shokëve/shoqeve; ☺ merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

NR.	TEMATIKA	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E PARASHIKUAR E TË NXËNIT	BURIMET
1.	<i>Gjuha dhe komunikimi muzikor</i>	Shkalla La minore	Loja e radhitjes së notave 8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 ku shkruhet me ngjyrë nota përkatëse dhe e lexojnë ose e këndojnë atë: La, Si, Do, Re, Mi, Fa, Sol, La.	• teksti i nxënësit; • interpretim me fyell ose në tastierë.
2.	<i>Teknika dhe procese</i>	Luajmë me fyell ose në tastierë, ushtrime në Do maxhor dhe La minor	Loja e radhitjes së notave 8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 ku shkruhet me ngjyrë nota përkatëse. Ata/ato vendosen sipas vendndodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshtemenë e klasës dhe secili/a lexon notën që mban në dorë: Do, Re, Mi, Fa, Sol, La, Si, Do.	• teksti i nxënësit; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; • shkalla Do+ në ngjitje dhe në zbritje në CD.
3.	Teknika dhe procese	Kënga “Ju fal këngën time”	Njeriu më i dashur Vendosja e disa fotografive me situata të ndryshme familjare apo shoqërore i vendos nxënësit/et të diskutojnë rreth konceptit të miqësisë dhe të dashurisë për një njeri të familjes apo shok/shoqe.	• teksti i nxënësit; • postera apo fotografi që tregojnë situata të ndryshme midis njerëzve; • CD me këngën.
4.	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Nota dhe pushimi 1/16	Gjejmë ndryshimet e shpejtësisë muzikore Vendosen dy fragmente muzikore 1. I ngadalë dhe 2. I shpejtë. Mësuesi/ja ngre pyetjen: a janë të gjitha vlerat e notave njësoj apo ndryshojnë nga njëra-tjetra, kur shpejtësia e muzikës ndryshon?	• teksti i nxënësit; • 2 shembuj muzikorë <i>ngadalë-shpejt</i>.
5.	Teknika dhe procese	Kënga “Yellow Submarine”	Emocioni i të kënduarit në një gjuhë të huaj Nxënësit/et këndojnë fragmente të shkurtra të këngëve që pëlqejnë më shumë në gjuhë të huaj. Pse u pëlqejnë ato? Në cilën gjuhë u pëlqen më shumë të këndojnë?	• teksti i nxënësit; • fotografi të grupit “Beatles”; • CD me këngën.

6.	Teknika dhe procese	Luajmë në fyell me notë 1/16	Parapërgatitje e ekzekutimit të tingujve shumë të shkurtër 1/16 me zë dhe pastaj me fyell ose tastierë.	• teksti i nxënësit/es; • fyelli/tastiera.
7.	Historia, shoqëria, muzika	Karakteristikat e instrumenteve	Të përbashkëtat dhe të ndryshimet Në klasë vendosen postera/ fotografi me instrumente të ndryshme. Gjenden të përbashkëtat dhe ndryshimet.	• teksti i nxënësit/es; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, • CD me shembuj konkretë.
8.	Gjuha dhe komunikimi muzikor.	Masa e paplotësuar	Plotësimi i një mendimi Në dërrasë shkruhet një fjali, së cilës i mungojnë fjalët e para. Nxënësit/et pasi e lexojnë e plotësojnë atë, sipas kuptimit të saj.	• teksti i nxënësit/es; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; • CD me shembuj muzikorë.
9.	Historia, shoqëria, muzika	Formacionet instrumentale	Të përbashkëtat dhe ndryshimet Vendosen fotografi të ndryshme të një, dy ose më shumë instrumentistëve. Diskutohet rreth tyre.	• teksti i nxënësit/es; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; • CD me shembuj muzikorë.
10.	Teknika dhe procese	Kënga “Eksploroj”	Unë dhe interneti Nxënësit/et eksplorojnë në internet vendet që pëlqejnë më shumë dhe diskutojnë për to njëri-tjetrin.	• teksti i nxënësit/es; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; • CD me këngën.
11.	Teknika dhe procese	Luajmë në fyell ose tastierë ushtrime me masën e paplotësuar.	Lojë me ritmin e paplotësuar Nxënësit/et luajnë ushtrime dhe pjesë të sugjeruara në librin e tyre, ose materiale shtesë të sjella nga mësuesi/ja.	• teksti i nxënësit/es, • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja

12.	Gjuha dhe komunikimi muzikor	“Termat dinamikë”	Dëgjojmë dhe kuptojmë shpejtësinë e muzikës Vendosen 3 fragmente muzikore dhe nxënësit/et identifikojnë llojin e shpejtësisë që luhet pjesa muzikore. Ata/ato diskutojnë pse ka rëndësi shpejtësia në muzikë.	• teksti i nxënësit; • CD me shembuj muzikorë.
Metodologjia Metoda ndërvepruese, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse. Puna në grup dhe puna individuale. Hetimi dhe zbulimi. Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase. Metoda integruese. Bashkëbisedim. Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues. Paraqitje në forma të ndryshme, përfshirë TIK. Projekte kurrikulare.				
Vlerësimi Vlerësimi përshkrues. Vlerësimi i tematikave përmbyllëse. Vlerësimi i dosjes/portofolit të nxënësit/es.				



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Shkalla muzikore La minore”		Situata e të nxënit: Loja e radhitjes së notave 8 nxënës/e mbajnë në duar nga një fletë A4 ku shkruhet me ngjyrë notën përkatëse dhe lexuar ose kënduar atë: La, Si, Do, Re, Mi, Fa, Sol, La.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - demonstroi kuptimin e shkallës muzikore; - ndërton shkallën La- në ngjitje dhe në zbritje; - komunikon qartë njohuritë muzikore, mbi shkallën muzikore; - këndon saktë nga ana intonacionit shkallën La- në ngjitje dhe në zbritje; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.		 Fjalë kyçe: - shkalla muzikore; - shkalla La-.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja; - shkalla La- në ngjitje dhe në zbritje në CD.			
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja përzgjedh 8 nxënës/e që mbajnë në duar nga një fletë A4 ku shkruhet me ngjyrë nota përkatëse: La, Si, Do, Re, Mi, Fa, Sol, La. Ata/ato vendosen sipas vendodhjes së notës në pentagramin e vizatuar në dyshemenë e klasës. Secili lexon notën që mban në dorë: La, Si, Do, Re, Mi, Fa, Sol, La.			
Ndërtimi i njohurive të reja Ora mësimore vazhdon më tej, teksa nxënësit/et shohin se nga vendndodhja e notave ata vijnë duke u ngjitur në pentagram njëri pas tjetrit dhe kuptojnë se shkalla është renditja graduale e 8 notave muzikore të vendosura njëra pas tjetrës, ku secila prej tyre ka një lartësi të caktuar. Ata/ato lexojnë shkallën dhe më pas fillojnë ta këndojnë atë disa herë.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në: - diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj mbi shkallën muzikore; - ndërtimin e shkallës La- dhe kuptimin e saj; - këndimin korrekt të shkallës në intonacion në ngjitje dhe në zbritje. - bashkëpunimin dhe këndimin në grup të shkallës. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit




Ushtrime dhe lojëra argëtuese

Dëgjohet një pasazh muzikor ku nxënësit/et dëgjojnë disa nota që ngjiten dhe zbresin. Ky është edhe çelësi që ata/ato duhet të gjejnë pasi kanë dëgjuar pasazhin.

• **Në vijim**, nxënësve/eve u kërkohet të shprehin me fjalët e tyre çfarë dëgjuan.

1. Lidh me shigjetë notën në tastierë me notën përkatëse në pentagram për të formuar shkallën La- minore.




2. Rretho përgjigjen e saktë.

• *Ndryshimi ndërmjet një shkalle maxhore dhe një minore është:*

- renditja e notave në mënyrë jo të njëpasnjëshme;
- ndryshimi i toneve dhe i gjysmëtoneve;
- ndryshimi i gradëve;
- notat e ulëta dhe të larta

3. Ndërto shkallën La minore në ngjitje dhe në zbritje.




Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



Ai/ajo **krijon** një ushtrim në kohën 3/4 me 8 masa nga nota La në notën La².

Shënime specifike:



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: “Luajmë në fyell ose në tastierë, ushtrim në Do maxhor dhe La minor”		Situata e të nxënit: Nxënësit/et luajnë ushtrime dhe pjesë të sugjeruara në librin e tyre, ose materiale shtesë të sjella nga mësuesi/ja.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ai/ajo: - luan apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara; - luan në instrument duke respektuar rregullat e lojës në instrument; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.		 Fjalë kyçe: - instrumenti i fyellit/tastierës; - rregullat e luajtjes në instrument.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - ushtrime të ndryshme; - instrumenti. muzikor.			
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja rikujton shkallën Do maxhore dhe La minore. Ai/ajo i nxit nxënësit/et të këndojnë shkallët në ngjitje dhe në zbritje, si dhe u kujton sërish rregullat e luajtjes me fyell dhe në tastierë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit/et ushtrohen me instrumentin e fyellit apo në tastierë me ushtrime mjaft të thjeshta muzikore në tonalitetin Do maxhor dhe La minor. Ata/ato përsërisin disa herë ushtrime ose pjesë nga teksti i tyre apo të sugjeruara nga mësuesi/ja.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në: - ushtrimin e instrumenteve në tonalitetin Do maxhor dhe La minor; - përsëritjen e saktë dhe me intonacion të materialeve të sugjeruara në tekst apo nga mësuesi/ja; - respektimin e interpretimit të njëri-tjetrit. - Detyrë: Nxënësit/et ushtrohen me materiale të tjera muzikore në shtëpi.			




Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

Ushtrim me instrumentin e fyellit/tastierës me masën e paplotësuar.

Rikujtohen:

- ⌚ rregullat e mbajtjes dhe të luajtjes në instrument;
- ⌚ ekzekutimi me masën e paplotësuar;
- ⌚ respektimi i vlerave të notës brenda masës së paplotësuar;
- ⌚ ekzekutimi i melodisë vetëm dhe në grup.



Moderato *Kanon* *Melodi franceze*

Ushtrimin në La minor, mësuesi/ja e shikon në tekstin e nxënësit/es.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

- Ai/ajo **ushtron** në instrument materiale të tjera muzikore në shtëpi.

■ PLANIFIKIMI DITOR PËR 3-MUJORIN E DYTË: DHJETOR - MARS

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: Kënga “Ju fal këngën time”		Situata e të nxëniet: Njeriu më i dashur Vendosja e disa fotografive me situata të ndryshme familjare ose shoqërore i nxit nxënësit/et të diskutojnë rreth konceptit të miqësisë dhe të dashurisë për një njeri të familjes apo shok shoqe.	
 Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Ai/ajo: - Lidh dhe komunikon qartë tekstin e këngës me njohuritë që ka për familjen dhe shoqërinë; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; - respekton këngët e kulturave të tjera.		 Fjalë kyçe: - familja; - shoqëria; - melodia e këngës; - teksti; - rregullat e këndimit.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - postera apo fotografi që tregojnë situata të ndryshme midis njerëzve (festa familjare etj.); - CD me këngën.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore dhe mjedisi: njohuri për shoqërinë; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari ndërvepruese ku mësuesi/ja sjell disa fotografi me situata të ndryshme familjare ose` shoqërore duke i nxitur nxënësit/et të diskutojnë rreth konceptit të miqësisë dhe të dashurisë për një njeri të familjes apo shokun/shoqen.			
Ndërtimi i njohurive të reja Ora mësimore vazhdon më tej, teksa nxënësit/et fillojnë të mësojnë hap pas hapi vijën melodike të këngës. Pasi e mësojnë të gjithë këngën ata/ato e përsërisin disa herë atë, duke respektuar ritmin, intonacionin si dhe rregullat e këndimit, vetëm dhe në grup. Ata/ato vazhdojnë të përsëritin këngën disa herë.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re; - këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit; - interpretimin e këngës me emocion; - për bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës); - këndimin korrekt në ritëm dhe intonacion. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Dëgjohet kënga “Ju fal këngën time” një herë me tekst dhe një herë pa tekst.

- Nxënësit **nxiten** të flasin, duke shprehur emocionet që krijon muzika dhe fjalët e këngës.
- **Vazhdohet** puna me mësimin e këngës, sipas hapave të mëposhtëm:

- o këndohet kënga varg pas vargu;
- o përsëriten e vargjet herë pas here;
- o këndohet strofa;
- o këndohet strofa dhe refreni;
- o përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- o interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- o këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

- Ai/ajo **përshkruan** figurën e nënës, duke shprehur ndjenjat e tij/saj për të, nëpërmjet një eseje.

Shënime specifike:



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Nota dhe pushimi 1/16”		Situata e të nxënit: Gjejmë ndryshimet e shpejtësisë muzikore Vendosen dy fragmete muzikore 1. <i>Ngadalë</i> dhe 2. <i>E shpejtë</i> . Mësuesi/ ja ngre pyetjen: a janë të gjitha vlerat e notave njësoj apo ndryshojnë nga njëra tjetra, kur shpejtësia e muzikës ndryshon?	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ai/ajo: - demonstroi kuptimin e notës dhe të pushimit me vlerë 1/16; - krijon dhe lexon punën e vet të krijuar me vlera të ndryshme notash dhe pushimesh përfshirë dhe 1/16; - paraqet krijimin e vet; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.		 Fjalë kyçe: - nota 1/16; - pushimi 1/16; - notë e shpejtë.	
 Burimet: - teksti i nxënësit - 2 shembuj muzikorë të shpejtë - të ngadalë.		Lidhja me fushat e tjera: - edukimi fizik, sportet dhe shëndeti: hapat e shpejtë – hapat e ngadalë.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos dy fragmete muzikore: 1. <i>Të ngadalë</i> . 2. <i>Të shpejtë</i> . Ai/ajo i nxit nxënësit/et duke i pyetur: A janë të gjitha vlerat e notave njësoj apo ndryshojnë nga njëra-tjetra, kur shpejtësia e muzikës ndryshon?			
Ndërtimi i njohurive të reja Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, teksa mësuesi/ja vendos një poster ose shkruan në dërrasë të zezë piramidën e notave, duke kujtuar sërish vlerat e notave dhe të pushimeve nga nota e plotë deri tek nota 1/16. Më pas nxënësit/et krijojnë një ushtrim të thjeshtë në kohën 2/4, duke përfshirë brenda masave edhe notën apo pushimin 1/16. Ata/ato i lexojnë krijimet e tyre para klasës.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - kuptimin e vlerës së notës dhe të pushimit 1/16 qoftë gjatë dëgjimeve muzikore, qoftë gjatë krijimeve të veta; - shpjegimin e formimit të një mase muzikore pavarësisht kohës që ajo ka, duke përdorur notën dhe pushimin 1/16; - krijimin e ushtrimit në kohën 2/4 me vlerë note 1/16; - bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Ushtrime dhe lojëra argëtuese

-  Nxënësit/et **dëgjojnë** 2 fragmente muzikore, të cilat ekzekutohen me nota të shpejta ose të gjata. Ata/ato nxiten që të flasin rreth asaj që dëgjojnë.
- Vendoset një poster ose shkruhet në dërrasë të zezë piramida e notave dhe e pushimeve, duke u ndalur më gjatë te nota dhe pushimi 1/16.
 - Nxënësit/et nxiten të flasin ose të bashkëveprojnë për plotësimin e fishave të përgatitura nga mësuesi/ja.
-  **Dëgjojen** për disa minuta fragmente të kënduara ose të luajtura në instrument ku dëgjohet qartë vlera e notës 1/16.
- 1. Shkruaj** një rresht me notën dhe pushimin 1/16.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

- **Ai/ajo** krijon një ushtrim në kohën 2/4, me 8 masa muzikore, duke përdorur notën dhe pushimin 1/16.

Shënime specifike:

This image shows a blank sheet of music paper with ten horizontal staves. In the bottom right corner, there is a cartoon illustration of a brass instrument, possibly a trumpet or trombone, with two musical notes floating above it. The paper is otherwise empty, providing space for writing or drawing.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: Kënga “Yellow Submarine”		Situata e të nxënit: Emocioni i të kënduarit në një gjuhë të huaj Nxënësit/et këndojnë fragmente të shkurtra të këngëve që pëlqejnë më shumë në gjuhë të huaj. Pse u pëlqejnë ato? Në cilën gjuhë u pëlqen më shumë t’i këndojnë?	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Ai/ajo: - komunikon qartë informacionin që ka për krahinën/qytetin e vet; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.		 Fjalë kyçe: - nëndetëse; - grupi muzikor “Beatles”.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - fotografi të grupit “Beatles”; - CD me këngën.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore: historia; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku nxënësit/et këndojnë fragmente të shkurtra këngësh në gjuhë të huaj që pëlqejnë më shumë. Pse u pëlqejnë ato? Në cilën gjuhë u pëlqen më shumë të këndojnë?			
Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit/et kuptojnë rëndësinë dhe personifikimin e grupit “Beatles” dhe të tekstit të këngës. Ata/ato flasin për famën dhe përfaqësimin e tyre në Evropë dhe SHBA. Mësuesi/ja u mëson nxënësve/eve këngën në grup, duke respektuar karakteristikat e saj. Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, sidomos të këndimit në grup.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - diskutim me njëri-tjetrin rreth karakteristikave të këngës; - këndim duke interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion; - interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion, vetëm dhe në grup. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et (ese/filmime/histori rreth temës), ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Dëgjohet kënga “Yellow Submarine”.

- Nxënësit **nxiten** të flasin rreth këtij grupi mjaft të njohur duke sjellë *ngjarje, episode, kujtime dhe fragmente në DVD* rreth tyre.
- **Vazhdohet** puna me mësimin e këngës, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndoheti strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocione;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



Ai/ajo:

- **Gjen** informacion nga burime të ndryshme për grupin “Beatles” dhe diskuton për të në klasë.
- **Përshkruan** emocionet që i krijohen nga kjo këngë, në një ese të shkurtër.

Shënime specifike:



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: “Luajmë në fyell ose tastierë me notën dhe pushimin 1/16 ”		Situata e të nxënit: Parapërgatitje e ekzekutimit të tingujve shumë të shkurtër 1/16 me zë dhe pastaj me fyell.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - demonstroi kuptimin e notës dhe të pushimit me vlerë 1/16 gjatë luajtjes në fyell/tastierë; - ekzekuton në fyell/tastierë ushtrime apo pjesë të shkurtra me vlera të ndryshme notash dhe pushimesh përfshirë dhe 1/16.		 Fjalët kyçe: - nota 1/16; - pushimi 1/16.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.			
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja fillon parapërgatitjet e ekzekutimit të tingujve shumë të shkurtër 1/16 me fyell/tastierë. Përsëritin disa herë nota të shkurtra 1/16.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja vazhdon më tej veprimtarinë, duke ndërtuar në dërrasë të zezë një ushtrim të thjeshtë në kohën 2/4 ku përfshihen edhe vlera të notave 1/16. Nxënësit/et ushtrohen duke luajtur në fyell/tastierë sipas rastit këtë ushtrim për të kuptuar më mirë notën 1/16. Ai/ajo i nxit nxënësit/et të luajnë në instrument, solo dhe në grup. Ata/ato shprehin nëpërmjet lojës aftësinë e tyre, por gjithmonë me ndihmën e mësuesit/es, pasi nota dhe pushimi 1/16 janë pak të vështirë në ekzekutimin në instrument, pasi duhet shumë teknikë.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në: - luajtjen e notës 1/16 në fyell ose në tastierë; - kryerjen e ushtrimeve të thjeshta ose në luajtjen e ndonjë pjese në kohën 2/4 me nota 1/16.			




Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

• Ushtrim me instrumentin e fyellit ose të tastierës me notën dhe pushimin 1/16:

• Nxënësit/et:

- ⊗ ekzekutojnë notën 1/16 dhe pushimin e saj;
- ⊗ ekzekutojnë me ndjenjë dhe emocion;
- ⊗ ekzekutojnë vetëm ose në grup ushtrimin e mësuar.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

- Ai/ajo përsërit ushtrimet me notë 1/16 në shtëpi.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Historia, shoqëria, muzika Tema mësimore: “Karakteristikat e instrumenteve”		Situata e të nxënit: Të përbashkëtat dhe ndryshimet Vendosen postera/fotografi me instrumente të ndryshme. Gjenden të përbashkëtat dhe ndryshimet.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dëgjon në CD dhe dallon përmes timbrit instrumentet muzikore; - klasifikon instrumentet muzikore sipas materialit dhe ndërtimit; - shfaq parapëlqimin e vet për një instrument, duke sjellë shembuj të ndryshëm dëgjimorë. - respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve gjatë diskutimeve.		 Fjalë kyçe: - violinë; - violingël; - kontrabas; - flaut; - klarinetë; - tambur; - këmborë; - triangolo; - trompa.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale nga enciklopedi, - materiale të parapërgatitura nga mësuesi/ja për instrumentet muzikor, - shembuj muzikore në CD.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore: historia; - shkencat e sakta: fizika. Lidhja me temat ndërkurrikulare - teknologjia.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja vendos dy postera/fotografi me instrumente të ndryshme. Gjenden të përbashkëtat dhe ndryshimet. Më pas vendos në magnetofon një pjesë muzikore që luhet me dy instrumente të ndryshme, duke i nxitur nxënësit/et të gjejnë të përbashkëtat dhe ndryshimet.			
Ndërtimi i njohurive të reja Vendosja e shembujve muzikorë të luajtur nga instrumente të ndryshme u zhvillon nxënësve/eve të dëgjuarit e kujdesshëm për të kuptuar sadopak ndryshimin jo vetëm nëpërmjet pamjes, por edhe nëpërmjet dëgjimit. Nxënësit/et pasi kanë parë fotografitë dhe kanë dëgjuar disa nga këto instrumente përzgjedhin instrumentin që do të dëshironin të dëgjonin më shpesh. Mësues/ei/ja shpjegon evoluimin e instrumenteve nga krijimi deri në ditët tona.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - diskutim me njëri-tjetrin rreth karakteristikave të instrumenteve me tastierë; - dëgjim dhe veçim të instrumentit të parapëlqyer me tastierë; - shpjegimin e pjesëve që përbëjnë këto instrumente muzikore; - gjetjen e të dhënave mbi evoluimin e këtyre instrumenteve muzikore në kohë. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et ruhen në dosjet e tyre personale.			


Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimi



Ushtrime dhe lojëra argëtuese

• **Dëgjohen** disa fragmente muzikore në CD të luajtura nga instrumente muzikore të ndryshme dhe nxënësit/et identifikojnë dhe flasin ato që dinë mbi këto lloj instrumentesh.

1. **Lidh** me shigjetë emrin e instrumentit me figurën përkatëse.



violinë

triangolo

tromba

pianoforte

tamburi

violinçel

- **Flit** për tingullin e instrumentit muzikor që të pëlqen më shumë. Mundohu të imitosh me zë ose fishkëllimë ndonjë pjesë të luajtur me të.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es




Ai/ajo:

- **gjen** në internet kuriozitete për krijimin e instrumenteve të ndryshme muzikore;
- **kërkon** në internet rreth jetës së kompozitorëve që kanë shkruar për instrumentet e mësuara.

Shënime specifike:

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Masa e paplotësuar”		Situata e të nxënit: Plotësimi i një mendimi. Shkruhet një fjali në dërrasë ku i mungojnë fjalët e para. Nxënësit/et pasi e lexojnë plotësojnë kuptimin e saj sipas idesë së saj.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - demonstroi kuptimin e masës së paplotësuar në muzikë; - demonstroi kuptimin e saj gjatë krijimit të vet; - shpjegon ngjashmërinë e masës së paplotësuar me një mendim të paplotësuar në letërsi.		☒ Fjalë kyçe: - masa e paplotësuar.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD me shembuj muzikorë.		Lidhja me fushat e tjera: - gjuha dhe komunikimi.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja shkruan një fjali në dërrasë që i mungojnë fjalët e para. Nxënësit/et pasi e lexojnë, plotësojnë kuptimin e saj.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja vazhdon më tej veprimtarinë, duke shkruar me kujdes shembujt muzikorë dhe duke nxitur nxënësit/et të gjejnë ndryshimin e vlerave të notave të kohës 4/4 brenda masës, të cilat plotësohen në masën e fundit. Më pas shpjegohet roli dhe funksioni që luan në muzikë <i>masa e paplotësuar</i> . Nxënësit/et punojnë shembuj me masën e paplotësuar në fletoren e tyre, duke plotësuar krijimin me të gjitha elementet përkatëse.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - kuptimin e funksionimit të masës së paplotësuar në një pjesë muzikore; - krijimin e një pune të vetën, duke përdorur masën e paplotësuar; - shpjegimin e qartë të krijimit të tyre. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			




Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Ushtrime dhe lojëra argëtuese

1. Gjej në shembujt e mëposhtëm masën e paplotësuar dhe rrethoje atë.



2. Gjej në libër shembuj muzikorë ku përdoret masa e paplotësuar dhe shkruaji ato në fletore. Shembulli i parë është dhënë.

1. Në fq.47 në partiturën e këngës “Yellow submarine” fillon me masë të paplotësuar.

2.

3.

4.


5.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

- Ai/ajo **krijon** një ushtrim në kohët e mësuara 2/4, 3/4 ose 4/4 me 8 masa duke përdorur masën e paplotësuar.

Shënime specifike:



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Historia, shoqëria, muzika Tema mësimore: “Formacionet instrumentale”		Situata e të nxënit: Të përbashkëtat dhe të ndryshmet. Vendosen fotografi të ndryshme 1 instrumentist, 2, 3, 4 dhe më shumë. Diskutohet rreth tyre.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dëgjon në CD dhe identifikon ndonjë lloj - formacioni instrumental muzikor; - klasifikon formacionet muzikore sipas - njohurive që merr; - shfaq parapëlqimin e vet për një formacion muzikor, duke sjellë shembuj të ndryshëm dëgjimorë me CD. - respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/ shoqeve - gjatë diskutimeve të dëgjimit të pjesëve muzikore.		 Fjalë kyçe: - trio; - kuartet; - muzikë dhome; - bandë; - fanfarë.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD me shembuj muzikorë.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore: historia; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia. Lidhja me temat ndërkurrikulare - teknologjia.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja vendos postera/fotografi të formacioneve të ndryshme muzikore dhe i nxit nxënësit/et të flasin rreth tyre. Ai/ajo mund të vendosë edhe CD me fragmente të shkurtra muzikore, duke i nxitur përsëri nxënësit/et të gjejnë se çfarë informacioni kanë për formacionet muzikore që dëgjojnë. Të gjithë nxënësit/et shprehin njohuritë e tyre dhe respektojnë mendimin e njëri-tjetrit.			
Ndërtimi i njohurive të reja Vendosja e shembujve muzikorë të luajtur nga formacione të ndryshme muzikore zhvillon të dëgjuarit e kujdesshëm nxënësve/eve që të kuptojnë sadopak ndryshimin jo vetëm nëpërmjet përbërjes së numrit që ka një formacion muzikor, por edhe nëpërmjet identifikimit nëpërmjet dëgjimit. Nxënësit/et pasi kanë parë fotografitë dhe kanë dëgjuar disa nga këto formacione përzgjedhin formacionin muzikor që do të dëshironin të dëgjonin më shpesh në <i>youtube</i> , <i>CD etj.</i> Mësuesi/ja shpjegon evoluimin e formacioneve muzikore nga krijimi deri në ditët tona.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - diskutimet me njëri-tjetrin rreth karakteristikave të formacioneve muzikore; - dëgjim dhe veçim të formacionit muzikor të parapëlqyer; - klasifikimin e instrumenteve që përbëjnë këto formacione muzikore. - gjetjen e të dhënave mbi evoluimin e këtyre instrumenteve muzikore në kohë. - Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et (ese/filmime/histori rreth temës), - ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Ushtrime dhe lojëra argëtuese

● **Dëgjohen** disa fragmente muzikore në CD të luajtura nga formacione të ndryshme muzikore. Nxënësit/et i identifikojnë dhe flasin ato që dinë mbi to.


1. Lidh me shigjetë emrin e formacionit muzikor me figurën përkatëse.

Kuartet hargesh

Trio me pianofort

Bandë simfonike

Banda e parë, në Shkodër



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



Ai/ajo:

- **gjen** në internet kuriozitete për evoluimin e formacioneve të ndryshme muzikore;
- **kërkon** në internet rreth jetës së kompozitorëve që kanë shkruar për formacione të ndryshme muzikore.

Shënime specifike:

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: Kënga “Eksploroj”		Situata e të nxënit: Unë dhe interneti Nxënësit/et kërkojnë në internet për vendet që pëlqejnë më shumë dhe i diskutojnë ato mes tyre.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - mëson këngën saktë në intonacion dhe ritëm; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.		 Fjalë kyçe: - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD me këngën.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore: njohuri për - shoqërinë; - shkencat e sakta: informatika; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku nxënësit/et kërkojnë në internet, zgjedhin vendet që pëlqejnë më shumë dhe i diskutojnë mes tyre në klasë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja u mëson nxënësve/eve këngën në grup, duke respektuar karakteristikat e saj. Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe të të kënduarit në grup.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - diskutimet me njëri-tjetrin rreth karakteristikave të këngës; - interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion; - gjetjen e informacionit për vendet që pëlqen më shumë për të kaluar pushimet; - interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion, vetëm dhe në grup.			
- Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et (ese/filmime/histori rreth temës), ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

 Dëgjohet kënga “Eksploruj”.

- Nxënësit/et **nxiten** të flasin për fjalën eksploroj dhe për vendet që pëlqejnë më shumë, emrat e të cilave i shkruajnë në dërrasë.
- **Vazhdohet** puna me mësimin e këngës “Eksploroj” sipas hapave të mëposhtëm:
 - këndohet kënga varg pas vargu;
 - përsëriten vargjet herë pas here;
 - këndohet strofa;
 - këndimi i strofës dhe refrenit;
 - përsëritet kënga nga fillimi në fund;
 - interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
 - këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



Ai/ajo:

- **gjen** këngë të tjera në internet që i kushtohen kohës që nxënësit/et kalojnë në internet.
- **gjen** informacion mbi jetën dhe veprën e kompozitorit Edmond Zhulali.

Shënime specifike:

[illegible]

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: “Luajmë me fyell ose në tastierë me masën e paplotësuar”		Situata e të nxënët: Nxënësit/et luajnë ushtrime dhe pjesë të sugjeruara në librin e tyre, ose material shtesë të sjellë nga mësuesi/ja.	
 Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - luan ose këndon duke respektuar simbolikat e mësuara; - luan në instrument duke respektuar rregullat e këtij instrumenti; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.		 Fjalë kyçe: - instrumenti i fyellit/tastierës; - rregullat e luajtjes në instrument.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - ushtrime të ndryshme; - instrumenti muzikor.			
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja kujton masën dhe vlerat e notave dhe pushimeve që zbatohen në një masë muzikore. Ai/ajo kujton edhe rregullat e luajtjes në instrumentin e fyellit/tastierës.			
Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit/et ushtrohen me instrumentin e fyellit apo të tastierës në ushtrime mjaft të thjeshta muzikore me masën e paplotësuar. Ata/ato i përsërisin disa herë ushtrimet ose pjesët nga teksti i tyre apo të sugjeruara nga mësuesi/ja.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në:</i> - ushtrimin e instrumenteve me masën e paplotësuar; - përsëritjen e saktë dhe me intonacion të materialeve të sugjeruara në tekst apo nga mësuesi/ja; - respektimin e interpretimit të njëri-tjetrit.			
- Detyrë: Nxënësit/et ushtrohen me materiale të tjera muzikore në shtëpi.			




Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

- Ushtrim me instrumentin e fyellit/tastierës me masën e paplotësuar.

• Rikujtohen:

- ⊕ rregullat e mbajtjes dhe të luajtjes në instrument;
- ⊕ ekzekutimi me masën e paplotësuar;
- ⊕ respektimi i vlerave të notës brenda masës së paplotësuar;
- ⊕ ekzekutimi i melodisë vetëm dhe në grup.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

- Ai/ajo **ushtron** në instrument materiale të tjera muzikore në shtëpi.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Termet dinamikë”		Situata e të nxënit: Dëgjojmë dhe kuptojmë shpejtësinë e muzikës Vendosen 3 fragmente muzikore dhe nxënësit/et identifikojnë llojin e shpejtësisë me të cilën luhet pjesa muzikore. Diskutojnë pse ka rëndësi shpejtësia në muzikë.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - demonstroi kuptimin e funksionit/rolit të termave dinamikë muzikorë; - i zbaton ato gjatë këndimit; - shpjegon saktë kuptimin e tyre kur i shikon në një partiturë; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.		 Fjalë kyçe: - terma dinamikë; - adaxhio; - andante; - alegro.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të ndryshme të parapërgatitura nga mësuesi/ja; - shembuj muzikorë në CD ku gjendet përdorimi i termave dinamikë.		Lidhja me fushat e tjera: - gjuhët dhe komunikimi: letërsia; - shkencat e sakta: fizika; - shkencat shoqërore: fiskultura.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos 3 fragmente muzikore dhe nxënësit/et identifikojnë llojin e shpejtësisë me të cilën luhet pjesa muzikore. Ata diskutojnë pse ka rëndësi shpejtësia në muzikë dhe çfarë kuptimi merr pjesa muzikore në varësi të përdorimit të termave dinamikë.			
Ndërtimi i njohurive të reja - Ora mësimore vazhdon më tej, teksa nxënësit/et kuptojnë funksionin dhe rolin e termave dinamikë muzikorë në një pjesë kur ajo luhet apo këndohet. Më pas ata/ato i zbatojnë ato gjatë këndimit, duke kuptuar se si ndryshon emocioni i pjesës/këngës. - Nxënësi/ja shpjegon saktë kuptimin e tyre kur i shikon në një partiturë, duke ndarë përvojën e vet me të tjerët.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj mbi termat dinamike; - shpjegimin e rolit dhe të funksionit të tyre gjatë ekzekutimit; - zbatimin e tyre gjatë këndimit; - bashkëpunimin dhe në diskutimet në grup. - Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Ushtrime dhe lojëra argëtuese




Vendosen për dëgjim 3 fragmente muzikore dhe nxënësit/et identifikojnë llojin e shpejtësisë me të cilën luhet pjesa muzikore. Ata/ato diskutojnë pse ka rëndësi shpejtësia në muzikë.

Në vijim u kërkohet nxënësve/eve të shprehin me fjalët e tyre çfarë dëgjuan dhe të shpjegojnë se pse janë të rëndësishme termat dinamikë.

1. Rretho, e vërtetë apo e gabuar.

- | | | |
|--|---|---|
| 1. Allegro – shpejtësi e ngadaltë. | V | G |
| 2. Grave – shpejtësi mesatare. | V | G |
| 3. Presto – shpejtësi e shpejtë. | V | G |
| 4. Moderato – shpejtësi e ngadaltë. | V | G |
| 5. Andante – shpejtësi mesatare. | V | G |
| 6. Ralento – pakëson shpejtësinë. | V | G |
| 7. Açelerando – shton shpejtësinë. | V | G |
| 8. A tempo – kthim në shpejtësinë e mëparshme. | V | G |

2. Plotëso kutitë bosh, duke formuar fjalëkryqin.



1. Tregon lëvizjet e ngadalta.
2. Tregon se shpejtësia duhet zvogëluar.
3. Tregon se shpejtësia duhet të kthehet në shpejtësinë fillestare.
4. Tregon lëvizjet mesatare.
5. Tregon se shpejtësia shtohet.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



• Ai/ajo **gjen** këngë ose pjesë muzikore që i përgjigjen shpejtësive muzikore të mësuara dhe krijon CD e tij/saj.

Shënime specifike:

Verifiko njohuritë e tua muzikore


1. **Rretho** përgjigjen e saktë.



Nota është sa 1/16 e notës:

- a) së plotë; b) gjysmë; c) katërshe.


2. **Përdor** notën ose pushimin 1/16 në vend të pikëpyetjes.



3. **Plotëso** saktë përkufizimet.

- a) Masa e paplotësuar është

4. **Lidh** me shigjetë duke përdorur tri ngjyra: blu, e verdhë, e kuqe. Çdo ngjyrë të lidhë termin me grupin që bën pjesë.



Lento (e verdhë)

Moderato (blu)


Veloçe (e kuqe)

lento
andantino
vivaçe
andante
grave
presto
allegretto
adaxhio
largo
prestissimo

5. **Plotëso** vendet bosh në fjalitë e mëposhtme.

- a) Në instrumentet aerofone tingulli formohet nga
- b) Në instrumentet kordofone tingulli formohet nga
- c) Në instrumentet idiofone tingulli formohet nga
- d) Në instrumentet membranofone tingulli formohet nga

6. Shkruaj poshtë secilës figurë emrin e formacionit orkestror:




7. Plotëso përkufizimet e mëposhtme:

Orkestra simfonike formohet nga



8. Lidh me shigjetë emrin e instrumentit me grupin ku bën pjesë.



- a) viola
- b) kornoja
- c) organoja
- d) ksilofoni
- e) kitara elektrike
- f) tamburi
- g) saksofoni
- h) mandolina
- i) pianoforte
- j) gongu
- k) sintetizatori

- gr. kordofon
- gr. aerofon
- gr. membranofon
- gr. idiofon
- gr. kordofon
- gr. membranofon
- gr. kordofon
- gr. kordofon
- gr. membranofon
- gr. idiofon
- gr. kordofon

9. Plotëso vendet bosh duke kujtuar.

Për të kënduar bukur, duhet të kesh parasysh:

- a)
- b)
- c)
- ç)



PLANIFIKIMI TREMUJOR: PERIUDHA: PRILL – QERSHOR

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi/ja:

1. krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike;
2. kupton drejt mesazhin artistik;
3. demonstroi një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, të simboleve, të shenjave dhe të formave muzikore;
4. shfrytëzon mjetet artistike, mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë, në mënyrë të pavarur.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi/ja:

1. kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur;
2. zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike;
3. zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese;
4. ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim muzikor.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Nxënësi/ja:

1. klasifikon mjetet për të realizuar një krijim muzikor;
2. përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor;
3. krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi/ja:

1. ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.

Kompetenca personale

Nxënësi/ja:

1. zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore;
2. përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollë dhe në komunitet;
3. rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe në krijimin e besimit te të tjerët.

Kompetenca qytetare

Nxënësi/ja:

1. bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;
2. respekton punën e të tjerëve;
3. bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, brenda dhe jashtë shkollës.

Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:

1. krijon informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;
2. njeh mjete të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të lëndës		
Krijimi muzikor:	Interpretimi muzikor:	Vlerësimi muzikor:
Nxënësi/ja: ♪ krijon në kohët 3/8 dhe 6/8; ♪ krijon duke përdorur kombinime të ndryshme vlerash, notash dhe pushimesh në ritmet e mësuara; ♪ demonstroi kuptimin e koronës dhe të stakatos gjatë shpjegimit të krijimit të vet; ♪ komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocione të këngëve që këndon; ♪ provon të këndojë fragmente të vogla muzikore për të kuptuar ndryshueshmërinë e muzikës sipas ritmeve që ndjek.	Nxënësi/ja: ◆ demonstroi gjatë interpretimit të këngëve simbolet muzikore; ◆ luan në instrumenta dhe këndon duke respektuar simbolikat e mësuara; ◆ këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; ◆ interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion, në ngjarje të klasës apo të shkollës; ◆ luan me fyell në kohën e thjeshtë 3/8; ◆ luan me fyell në kohën e thjeshtë 6/8; ◆ përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të paraqitur punën e vet. 	Nxënësi/ja: ● shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë respektimit të simboleve; ● shpreh emocionet e veta për këngët që këndon; ● përdor një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, për të shpjeguar përjetimin emocional të pjesëve muzikore që dëgjon; ● bën lidhjen ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, instrumentet apo vokalin dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; ● bën gjykime kritike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në <i>format muzikore, si sonata</i>; ● komunikon mendimin e vet rreth veprave muzikore që dëgjon; ● reflekton emocionet që i krijon një vepër muzikore gjatë kohës që interpretohet/luhet; ● shpreh mendimin e vet rreth pjesës muzikore që dëgjon; ● përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; ● respekton mendimin e shokëve/shoqeve; ● merr pjesë në veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

■ Tremujori i tretë: Prill-Qershor, planifikimi i temave mësimore

1.	Historia muzika dhe shoqëria	Orkestrat simfonike	Orkestra dhe banda Vendosen dy fragmente muzikore të luajtura nga banda frymore dhe një orkestër simfonike. Gjatë dëgjimit gjenden ndryshimet nga vetë nxënësit/et.	• teksti i nxënësit; • libra të ndryshëm muzikorë; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
2.	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Korona dhe stakato	Ndryshueshmëria Dëgjohen dy fragmente muzikore ku dallohen qartë stakato dhe korona. Nxënësit/et diskutojnë rreth asaj që dëgjojnë, duke bërë krahasimet midis këtyre dy koncepteve muzikore.	• teksti i nxënësit; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
3.	Teknika dhe procese	Kënga “E thotë kënga çfarë ka zemra”	Vendlindja ime Nxënësve/eve ju shpërndahen disa fisha të parapërgatitura nga mësuesi/ja me karakteristika nga qytete të ndryshme. Ata/ato do të bëjnë dallimin e kulturave.	• teksti i nxënësit; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; • CD me këngën.
4.	Historia, shoqëria, muzika	Instrumentet me tastierë	Situata e të nxënit: Kuice dëgjimore Vendosen disa fragmente muzikore në CD të luajtura nga instrumente me tastierë dhe nxënësit/et flasin ato që dinë për këto lloj instrumentesh.	• teksti i nxënësit; • materiale përgatitura nga mësuesi/ja.
5.	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Koha 3/8 dhe 6/8	Valsi Vendosen për dëgjim disa fragmente muzikore, të cilat janë të ritmeve të ndryshme. Nxënësit/et pyeten nëse e dallojnë ritmin që i bën të vallëzojnë, duke u shprehur sa lëvizje bëhen gjatë kërcimit.	• teksti i nxënësit; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
6.	Teknika dhe procese	“Luajmë në fyell ose tastierë në kohën 3/8 dhe 6/8”	Loja e ritmit vals Nxënësit/et luajnë ushtrime dhe pjesë të sugjeruara në librin e tyre, ose material shtesë të sjellë nga mësuesi/ja.	• teksti i nxënësit; • ushtrime të ndryshme; • instrumenti muzikor.


7.	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Shenjat e shartimit	Nxënësit/et nxiten të kërkojnë në partiturën e një kënge (të paraqitur me projektor, apo të përcaktuar më parë nga mësuesi/ja) dhe të gjejnë aty disa shenja të veçanta, të cilat janë #, b dhe bekuadër. Nxënësit/et pyeten se çfarë funksioni mund të kenë shenjat në muzikë.	• teksti i nxënësit; • materiale të përgatitur nga mësuesi/ja; • CD me shembuj konkretë.
8.	Historia, shoqëria, muzika	Format e thjeshta muzikore	Të përbashkëtat dhe të ndryshmet. Vendosen fotografi të ndryshme të një ose më shumë instrumentistëve. Diskutohet rreth tyre.	• teksti i nxënësit; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; • CD me shembuj muzikorë.
9.	<i>Teknika dhe procese</i>	Kënga “Dhuratë për ditëlindje”	Ditëlindja ime Nxënësit/et nxiten të shkruajnë mbi festat e ditëlindjeve të tyre. Pastaj diskutojnë mbi dhuratat që kanë marrë.	• teksti i nxënësit; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; • CD me këngën.
10.	Historia, shoqëria dhe muzika	Sonata	Vendosen në CD disa fragmente muzikore nga sonata të njohura dhe nxiten nxënësit/et të flasin rreth tyre.	• teksti i nxënësit; • materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; • CD me shembuj muzikorë.
11.	Teknika dhe procese	Projekt kurrikular	Muzika përmes njohurive tona.	• CD me shembuj muzikorë.
Metodologjia Metoda ndërvepruese, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse. Puna në grup dhe puna individuale. Hetimi dhe zbulimi. Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase. Metoda integrale. Bashkëbisedim. Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues. Paraqitje në forma të ndryshme, përfshirë TIK, projekte kurrikulare.				
Vlerësimi: - vlerësimi përshkrues; - vlerësimi i tematikave përmbyllëse; - vlerësimi i dosjes.				

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Historia, shoqëria, muzika Tema mësimore: “Orkestra simfonike”		Situata e të nxënit: Orkestra dhe banda Dëgjohen dy fragmente muzikore që luhen nga banda frymore dhe një orkestër simfonike. Gjatë dëgjimit, nxënësit/et i gjejnë vetë ndryshimet.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dëgjon në CD dhe identifikon llojin e orkestrës simfonike që dëgjon; - klasifikon sipas njohurive që merr orkestrën simfonike dhe llojet e tjera të formacioneve muzikore; - shpjegon përbërjen e një orkestre simfonike; - respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve gjatë diskutimeve.		 Fjalë kyçe: - orkestër simfonike	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD me shembuj muzikorë.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore: historia; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja vendos dy fragmente muzikore që luhen nga banda frymore dhe një orkestër simfonike, dhe i nxit përsëri nxënësit/et të gjejnë se çfarë informacioni kanë për këto lloj formacionesh muzikore që dëgjojnë. Ata/ato vetë gjejnë ndryshimet gjatë dëgjimit. Mësuesi/ja mund të vendosë edhe postera/fotografi të formacioneve të ndryshme muzikore, duke i nxitur kështu nxënësit/et të flasin rreth tyre. Ata/ato shprehin njohuritë e tyre dhe respektojnë mendimin e njëri-tjetrit.			
Ndërtimi i njohurive të reja Dëgjimi i shembujve muzikorë që luhen nga orkestra simfonike u zhvillon të dëgjuarit e kujdesshëm nxënësve/eve dhe i ndihmon të kuptojnë sadopak ndryshimin jo vetëm nëpërmjet përbërjes së numrit që ka një orkestër simfonike (ndryshe nga formacionet e tjera që janë më të vogla në përbërjen e numrit të instrumenteve muzikore), por edhe nëpërmjet gjithçkaje tjetër që mund të identifikohet përmes dëgjimit. Mësuesi/ja shpjegon evoulimin e formacioneve muzikore deri në krijimin e orkestrës simfonike.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në: - diskutim me njëri-tjetrin rreth përbërjes së instrumenteve muzikore në një orkestër simfonike; - dëgjimin e pjesëve të luajtura nga orkestra simfonike; - klasifikimin e instrumenteve që përbëjnë orkestra simfonike; - gjetjen e të dhënave mbi evoluimin e këtyre instrumenteve muzikore në kohë deri në krijimin e orkestrës simfonike. - Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et (ese/filmime/histori rreth temës), ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimi

• **Dëgjohen** disa fragmente muzikore në CD që luhen nga orkestra simfonike dhe nga kompleks dhome.

• **Vendoset** figura e një orkestre simfonike dhe diskutohet rreth instrumenteve:



1. **Rendit** disa karakteristika të orkestrës simfonike moderne, të kompleksit të dhomës dhe të bandës.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



Ai/ajo

• **gjen** në internet kuriozitete për evoluimin deri në krijimin e orkestrës simfonike;

• **kërkon** në internet rreth jetës së kompozitorëve që kanë shkruar për orkestrat simfonike.

Shënime specifike:

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Korona dhe stakato”		Situata e të nxënësve: Dëgjohen dy fragmente muzikore ku dallohen qartë stakato dhe korona. Nxënësit/et diskutojnë rreth asaj që dëgjojnë duke bërë krahasimet midis dy koncepteve muzikore.	
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - demonstroi se ka kuptuar rolin e stakatos dhe të koronës në muzikë; - provoi të lexojë apo të këndojë saktë kur shikon këto simbole muzikore; - komunikoi qartë njohuritë muzikore, mbi rolin e stakatos dhe të koronës në muzikë.		 Fjalë kyçe: - stakato; - korona.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - shembuj muzikorë në CD.		Lidhja me fushat e tjera: - - gjuha dhe komunikimi: letërsia.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos për dëgjim dy fragmente muzikore ku dallohen qartë dy konceptet muzikore <i>stakato</i> dhe <i>korona</i> . Nxënësit/et diskutojnë rreth asaj që dëgjojnë gjatë këtyre fragmenteve, duke bërë krahasimet midis këtyre dy koncepteve muzikore. Diskutimet i ndihmojnë ata të kuptojnë se sa të rëndësishme janë këto simbole muzikore në muzikë dhe çfarë kuptimi merr ajo prej tyre.			
Ndërtimi i njohurive të reja Ora mësimore vazhdon më tej, teksa mësuesi/ja fillon të shpjegojë hap pas hapi këto dy simbole muzikore, dhe i nxit nxënësit/et të këndojnë fragmente nga këngë apo ushtrime muzikore, duke përdorur pikërisht simbolet e mësuara. Ai/ajo i nxit që pas çdo demonstrimi të thonë se çfarë kuptojnë nga zbatimi i tyre me korrektësi.			
Pasi kanë kuptuar rolin e simboleve muzikore stakato dhe korona, nxënësit/et këndojnë një këngë tipike që i ka të dyja këto simbole.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në: - demonstrimet konkrete mbi simbolet e mësuara; - këndimin e tyre në momentin e duhur; - bashkëpunimin dhe në këndimin në grup për realizimin e detyrës (stakatos dhe koronës gjatë këngës).			
- Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			


Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Ushtrime dhe lojëra argëtuese


 Nxënësit/et **dëgjojnë** në CD disa fragmente/pasazhe muzikore që të kuptojnë mënyrën e këndimit.

1. Krijo një ushtrim në kohën 2/4 ku të përdoret shenja e **stakatos**.



2. Krijo një ushtrim duke respektuar këto kërkesa:


1. koha 2/4
2. vlera e notave të jetë 1/4, 2/4, 1/8 dhe me pikë vlere
3. të përdorë stakaton dhe koronën
4. të ketë 16 masa



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

- Ai/ajo **krij**on një ushtrim me 8 masa në kohën 4/4, duke përdorur koronën ose stakaton dhe e lexon saktë atë.

Shënime specifike:



■ TREMUJORI I TRETË: PLANIFIKIMI DITOR: PRILL - QERSHOR

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: Kënga “E thotë kënga çfarë ka zemra”		Situata e të nxënit: Vendlindja ime Nxënësve/eve u shpërndahen disa fisha të përgatitura nga mësuesi/ja me karakteristika nga qytete të ndryshme. Ata/ato bëjnë dallimin e kulturave.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - lidh dhe komunikon qartë tekstin e këngës me - njohuritë që ka për ritmet e ndryshme; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit - përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; - respekton këngë të kulturave të tjera.		 Fjalë kyçe: - miqësia; - barazia; - melodia e këngës; - teksti; - rregullat e këndimit.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD me këngën.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore dhe mjedisi: njohuri për shoqërinë; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Nxënësve/eve u shpërndahen disa fisha të përgatitura nga mësuesi/ja me karakteristika nga qytete të ndryshme. Ata/ato bëjnë dallimin e kulturave. Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të gjejnë këngë të tjera për vendlindjen dhe t’i këndojnë ato në klasë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Ora mësimore vazhdon më tej, teksa nxënësit/et fillojnë të mësojnë hap pas hapi vijën melodike të këngës. Pasi e mësojnë të gjithë këngën ata/ato e përsërisin disa herë atë, duke respektuar ritmin, intonacionin si dhe duke respektuar rregullat e këndimit, vetëm dhe në grup.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me këngën e re; - këndimin e saktë të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit; - interpretimin e këngës me emocion; - bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës); - këndimin korrekt në ritëm dhe në intonacion. - Detyra: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Dëgjohet kënga “E thotë kënga çfarë ka zemra” dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- ☐ këndohet kënga varg pas vargu;
- ☐ përsëriten e vargjet herë pas here;
- ☐ këndohet strofa;
- ☐ këndohet strofa dhe refreni;
- ☐ përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- ☐ interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- ☐ këndohet kënga vetëm dhe në grup.

- **Gjatë mësimet të këngës,** tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



- Ai/ajo **gjen** në internet ose nëpërmjet burimeve të ndryshme informacion mbi rivendlindjen e tij/saj.

Shënime specifike:

A hand-drawn musical staff with a treble clef and the word "Moderato" written above it. The staff is part of a larger sheet of music paper that is slightly torn at the bottom edge.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria		Situata e të nxënit: Kuice dëgjimore	
Tema mësimore: Instrumentet me tastierë		Nxënësit/et dëgjojnë në CD disa fragmente muzikore që luhen me instrumente me tastierë, për të cilat, flasin ato që dinë.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		 Fjalë kyçe:	
Nxënësi/ja:		- instrumentet muzikore me tastierë; - klasifikim; - përbërje e materialit të instrumentit; - ndërtim i instrumentit.	
- dëgjon në CD dhe identifikon përmes timbrit - instrumentet muzikore; - klasifikon instrumentet muzikore sipas - materialit dhe ndërtimit; - shfaq parapëlqimin e vet për një instrumenti, duke sjellë shembuj të ndryshëm; - respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/ shoqeve.			
 Burimet:		Lidhja me fushat e tjera:	
- teksti i nxënësit; - materiale nga interneti; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD, fragmente të ndryshme muzikore.		- shkencat shoqërore dhe mjedisi: historia dhe gjeografia; - gjuha dhe komunikimi.	
		Lidhja me temat ndërkurrikulare	
		- të njohim kulturën e njëri-tjetrit.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve			
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku zhvillohet një kuic i shkurtër përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore 20-30 sekonda. Vendoset CD me disa fragmente muzikore që luhen me instrumente muzikore me tastierë. Nxënësit/et i identifikojnë dhe flasin ato që dinë për to.			
Ndërtimi i njohurive të reja			
Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, teksa mësuesi/ja nëpërmjet një posteri ose një projektori paraqet lloje të ndryshme instrumentesh me tastierë, dhe kërkon nga nxënësit/et t'i identifikojnë ato sipas njohurive që kanë. Më pas, vendos në CD disa fragmente muzikore ku nxënësit/et dëgjojnë dhe dallojnë instrumentet me të cilat luhen (pianoforte, kalviçembal, piano, çeleste, organo). Ata/ato gjithashtu fillojnë të bëjnë krahasimin e cilësive të timbrit të instrumenteve. Të gjitha arsyet i shënojnë në fletore ose në dërrasë të zezë. Nxënësit/et mund të sjellin nga hulumtimet në internet edhe kuriozitete rreth krijimit dhe evoluimit të instrumenteve muzikore dhe t'i diskutojnë ato me shokët/shoqet.			
Vlerësimi			
Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> :			
- dëgjimin e fragmenteve muzikore instrumentale me tastierë, duke bërë klasifikimin e instrumenteve muzikore; - shpjegimin e timbrit të tingullit që lëshon instrumenti lidhur me përbërjen dhe ndërtimin e tij; - dallimin e pjesëve të ndryshme muzikore instrumentale dhe shpjegimin pse u pëlqen instrumenti; - gjetjen e pjesëve instrumentale sipas klasifikimit të instrumenteve që pëlqejnë, duke i sjellë në klasë me CD/DVD; - bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.			
- Detyrë: Nxënësit/et ushtrohen me materiale të tjera muzikore në shtëpi.			


Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Ushtrime dhe lojëra argëtuese

- **Dëgjohen** në CD disa fragmente muzikore të luajtura me instrumente muzikore me tastierë dhe nxënësit/et i identifikojnë dhe flasin për to.

1. **Lidh** figurën me emrin e instrumentit.



organo pianoforte klaviçembal celeste piano vertikale organo elektrike

- **Nxënësit** nxiten të flasin për instrumentin me tastierë që u pëlqen më shumë dhe nëse mundën të imitojnë me zë ose fishkëllimë ndonjë pjesë të luajtur me të.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



Ai/ajo:

- **gjen** në internet kuriozitete për krijimin e instrumenteve me tastierë muzikore;
- **kërkon** në internet rreth jetës së Franc Listit.

Shënime specifike:



Fusha: Arte		Lënda: Muzikë		Shkalla: III		Klasa: VII	
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Koha 3/8 dhe 6/8”				Situata e të nxënit: Valsi Dëgjohen disa fragmente muzikore, të cilat janë të ritmeve të ndryshme. Nxënësit/et nxiten të dallojnë ritmin që i bën të vallëzojnë, duke u shprehur sa lëvizje bëhen gjatë kërcimit.			
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - demonstron kuptimin e 3/8 dhe 6/8; - identifikon ritmin 3/8 dhe 6/8 nga ritmet e tjera muzikore; - krijon dhe lexon punën e krijuar në këto ritme muzikore; - paraqet krijimin e vet; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.				 Fjalë kyçe: - koha 3/8; - koha 6/8.			
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD me shembuj muzikorë vals, marsh, 4/4 etj.				Lidhja me fushat e tjera: - edukimi fizik, sportet dhe shëndeti; - vallëzimi ritmik.			
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve							
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos disa fragmente të shkurtra muzikore, të cilat janë të ritmeve të ndryshme. Nxënësit/et nxiten të dallojnë ritmin që i bën të vallëzojnë, duke u shprehur sa lëvizje bëhen gjatë kërcimit. Mësuesi/ja i pyet nxënësit/et nëse janë të gjitha vlerat e notave njësoj apo ndryshojnë nga njëra-tjetra, nëse shpejtësia e muzikës ndryshon etj.							
Ndërtimi i njohurive të reja Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, teksa mësuesi/ja vendos një poster ose shkruan në dërrasë të zezë kohën 3/8 dhe 6/8. Ai/ajo i nxit nxënësit/et të ndërtojnë masa me vlera notash dhe pushimesh të ndryshme në kohën 3/8 dhe 6/8. Më pas ata/ato krijojnë një ushtrim të thjeshtë në kohën 3/8 dhe 6/8, duke përfshirë tani brenda masave nota dhe pushime me vlera 1/8. Krijimet e tyre i lexojnë para klasës.							
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në: - kuptimin vlerës së kohës 3/8 dhe 6/8 qoftë gjatë dëgjimeve muzikore, qoftë gjatë krijimeve të veta; - shpjegimin e formimit të një mase muzikore pavarësisht kohës që ajo ka, duke përdorur notën dhe pushimin 1/8; - krijimin e ushtrimit në kohën 3/8; - bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.							

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit




Ushtrime dhe lojëra argëtuese

● Nxënësit/et **dëgjojnë** disa fragmente muzikore, të cilat ekzekutohen në ritme të ndryshme, me qëllim që nxënësit/et të dallojnë *ritmin 3/8* dhe *ritmin 6/8*. Ata/ato nxiten që të flasin rreth asaj që dëgjojnë.

- Mësuesi/ja **vendos** një poster ose shkruan në dërrasë të zezë masa muzikore të krijuara në mënyrë të tillë që formojnë kohën 3/8 dhe 6/8.
- Nxënësit/et **nxiten** të flasin ose të bashkëveprojnë për plotësimin e fishave të përgatitura nga mësuesi/ja në krijimin e kohës 3/8 dhe 6/8 ose krijojnë në fletoret e tyre ushtrime mbi këto kohë.

1. Duke bashkuar vlerat e disa notave, formohen disa të tjera.

- **Shëno** me X vlerën që formohet nga bashkimi i tyre.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

- Ai/ajo **krijon** një ushtrim në kohën 3/8 ose 6/8, me 8 masa muzikore, duke përdorur nota dhe pushime me vlerat e mësuara.

Shënime specifike:


A decorative illustration in the bottom right corner featuring a wireframe globe, a musical note, and a piano keyboard.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: “Luajmë në fyell ose në tastierë në kohën 3/8 dhe 6/8”		Situata e të nxënit: Nxënësit/et luajnë ushtrime dhe pjesë të sugjeruara në librin e tyre, ose material shtesë të sjellë nga mësuesi/ja.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - luan ose këndon - luan apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara; - luan në instrument duke respektuar rregullat e këtij instrumenti; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.		 Fjalë kyçe: - instrumenti i fyellit ose i tastierës; - rregullat e luajtjes në instrument.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - ushtrime të ndryshme; - instrumenti muzikor.			
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja rikujton kohën 3/8 dhe vlerat e notave dhe të pushimeve që zbatohen në një masë muzikore 3/8. Ai/ajo rikujton edhe rregullat e luajtjes në instrumentin e fyellit/tastierës.			
Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit/et ushtrohen me instrumentin e fyellit ose të tastierës me ushtrime të thjeshta muzikore në kohën 3/8. Ata/ato përsërisin disa herë ushtrimet ose pjesët e nga teksti i tyre apo të sugjeruara nga mësuesi/ja.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - ushtrimin e instrumenteve me kohën 3/8 dhe 6/8; - përsëritjen e saktë dhe me intonacion të materialeve të sugjeruara në tekst apo nga mësuesi/ja; - respektimin e interpretimit të njëri-tjetrit. - Detyrë: Nxënësit/et ushtrohen me materiale të tjera muzikore në shtëpi.			



Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

- Ushtrim me instrumentin e fyellit ose të tastierës me notën dhe pushimin 3/8 dhe 6-8 ku nxënësit/et ekzekutojnë me ndjenjë dhe emocion, vetëm ose në grup.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

- Ai/ajo përsërit ushtrimet me notë 3/8 dhe 6/8 në shtëpi.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor		Situata e të nxënësve: Muzika dhe simbolet	
Tema mësimore: “Shenjat e shartimit”		Nxënës/et nxiten të kërkojnë në partiturën e një kënge (të paraqitur me projektor, apo të përcaktuar më parë nga mësuesi/ja) dhe të gjejnë aty disa shenja të veçanta, të cilat janë diezis (#), bemol (b) dhe bekuadër (b). Ata/ato pyeten se çfarë funksioni mund të kenë ato në muzikë.	
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		 Fjalë kyçe:	
Nxënës/ja:		- shenjat e shartimit; - diezis (#); - bemol (b); - bekuadër (b).	
- demonstroi kuptimin e shenjave të shartimit; - kupton shenjat e shartimit #, b dhe b në ngjitje dhe në zbritje të një shkalle muzikore; - komunikon qartë njohuritë muzikore, mbi shenjat e shartimit dhe përdorimit të tyre në muzikë; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
 Burimet:		Lidhja me fushat e tjera:	
- teksti i nxënës/it; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - materiale nga interneti rreth temës; - shembuj muzikorë në CD.		- matematika: kuptimi i simboleve në matematikë psh: y, x, z.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve			
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja i nxiti nxënës/et të kërkojnë në partiturën e një kënge (të paraqitur me projektor apo të përcaktuar më parë nga mësuesi/ja) dhe të gjejnë aty disa shenja të veçanta, të cilat janë #, b dhe b. Ata/ato pyeten se çfarë funksioni mund të kenë në muzikë. Nxënësve/eve u kërkohet të flasin për <i>simbole</i> të tjera që ata/ato përdorin në lëndët e tjera si matematikë, fizikë, kimi etj. Diskutimet ndihmojnë që ata/ato ta kuptojnë vetë se sa të rëndësishme janë simbolet në jetën e përditshme.			
Ndërtimi i njohurive të reja			
Ora mësimore vazhdon më tej, teksa mësuesi/ja fillon të shpjegojë hap pas hapi tri shenjat e shartimit mjaft të përdorura në muzikë #, b, b duke vendosur në CD disa pasazhe ku këto shenja kryejnë funksionin e tyre. Gjithashtu ai/ajo vendos fotografi ose i shkruan në tabelë këto simbole, duke i shpjeguar ato. Pasi kanë kuptuar rolin e shenjave të shartimit, nxënës/et fillojnë t'i provojnë ato ose me zë, ose në një tastierë, duke dëgjuar ndryshimin melodik që ndodh.			
Vlerësimi			
Vlerësimi i nxënës/it/es do të bëhet për rezultatet e arritura në:			
- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj mbi shenjat e shartimit; - vendosjen dhe njohjen e tyre në vendin e duhur; - bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës.			
- Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënës/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit




Ushtrime dhe lojëra argëtuese

- Nxënësit/et **dëgjojnë** në CD një fragment/pasazh muzikor që të kuptojnë mënyrën e këndimit.

1. Plotëso përkufizimet e mëposhtme.

- Shenjat e shartimit vendosen _____ dhe _____.
- Shenja **#** vendoset në _____ dhe i _____.
- Shenja **b** vendoset në _____ dhe i _____.
- Shenja e **b** vendoset në _____ dhe e _____ e mëparshme.

2. Lidh me shigjetë emrin e shenjës së shartimit me shenjën që i përket.



#
bekuadri

b
diezi

b
bemoli

3. Gjej në libër shembuj muzikorë ku përdoren shenjat e shartimit dhe shkruaji në fletore. Një shembull është dhënë.


- Në fq.33 të tekstit në këngën “Gjuha jonë, barot e trëndelinë” përdoret shenja **#**
-
-
-
-



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es

- Ai/ajo **ndërton** një ushtrim në kohën 2/4 me 8 masa muzikore, duke përdorur shenjat e shartimit që ka mësuar.

Shënime specifike:



Fusha: Arte		Lënda: Muzikë		Shkalla: III		Klasa: VII	
Tematika: Historia,shoqëria, muzika				Situata e të nxënit:			
Tema mësimore: “Format e thjeshta muzikore”				Të përbashkëtat dhe të ndryshmet. Paraqiten fotografi të ndryshme me një, dy dhe shumë instrumentistë dhe diskutohet rreth tyre.			
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dëgjon në CD dhe identifikon ndonjë lloj formacioni instrumental muzikor; - klasifikon formacionet muzikore sipas njohurive që merr; - Shfaq parapëlqimin e vet për një formacion muzikor, duke sjellë - shembuj të ndryshëm dëgjimorë me CD. - respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve gjatë diskutimeve të dëgjimit të pjesëve muzikore.				 Fjalë kyçe: - fuga; - rondoja; - tema me variacion.			
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD me shembuj muzikorë.				Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore: historia; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia. Lidhja me temat ndërkurrikulare - letërsia			
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve							
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja vendos postera/fotografi të formacioneve të ndryshme muzikore dhe i nxit nxënësit/et të flasin rreth tyre. Ai/ajo mund të vendosë edhe CD me fragmente të shkurtra muzikore, duke i nxitur përsëri nxënësit/et të flasin për informacionin që kanë për këto lloj formacionesh muzikore që dëgjojnë. Ata/ato shprehin njohuritë e tyre dhe respektojnë mendimin e njëri-tjetrit.							
Ndërtimi i njohurive të reja Dëgjimi i shembujve muzikorë që luhen nga formacione të ndryshme muzikore u zhvillon nxënësve/eve të dëgjuarit e kujdesshëm që të kuptojnë sadopak ndryshimin jo vetëm nëpërmjet përbërjes së numrit që ka një formacion muzikor, por edhe nëpërmjet gjithçkaje tjetër që mund të identifikohet përmes dëgjimit. Nxënësit/et pasi shohin fotografitë dhe dëgjojnë disa nga këto formacione përzgjedhin formacionin muzikor që do të dëshironin të dëgjonin më shpesh në <i>youtube</i> , <i>CD</i> etj. Mësuesi/ja shpjegon evoluimin e formacioneve muzikore nga krijimi deri në ditët tona.							
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - diskutim me njëri-tjetrin rreth karakteristikave të formacioneve muzikore; - dëgjimin dhe veçimin e formacionit muzikor të parapëlqyer; - klasifikimin e instrumenteve nga të cilat përbëhen këto formacione; - gjetjen e të dhënave mbi evoluimin e këtyre instrumenteve muzikore në kohë. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et (ese/filmime/histori rreth temës), - ruhen në dosjet e tyre personale.							

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Ushtrime dhe lojëra argëtuese



Dëgjohen në CD fragmente muzikore që luhen nga formacione të ndryshme muzikore, të cilat nxënësit/et identifikojnë dhe flasin ato që dinë mbi to.

1. Rretho përgjigjen e saktë.

- Fuga është formë muzikore:
 - a) monodike;
 - b) polifonike.
- Tema me variacion është formë muzikore:
 - a) me tema që ngjajnë;
 - b) shumëpjesëshe.
- *Rondoja u krijua për herë të parë në:*
 - a) Itali;
 - b) Francë;
 - c) Gjermani.

2. Të lidhin emrin e formës muzikore me skemën e duhur.

- | | |
|----------------------|---------------|
| a) rondoja | 1. ABA |
| b) minueti | 2. AA'A''A... |
| c) tema me variacion | 2. ABACADA... |

3. Gjej e vërtetë apo e gabuar.

- Tema me variacion është një formë muzikore me parimin e “ngjashmërisë”.
- Fuga është formë muzikore, e interpretuar me një zë.
- Rondoja është formë muzikore instrumentale.
- Tema me variacon e ka prejardhjen nga muzika popullore.

V	G
☐	☐
☐	☐
☐	☐
☐	☐

- Nxënësit/et **nxiten** të flasin për formacionin muzikor që u pëlqen më shumë.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



Ai/ajo:

- **Gjen** në internet kuriozitete për evoluimin e formacioneve të ndryshme muzikore.
- **Kërkon** në internet rreth jetës së kompozitorëve që kanë shkruar për formacione të ndryshme muzikore.


Shënime specifike:

B. 

C. 

D. 

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: Kënga “Dhuratë për ditëlindje”		Situata e të nxënit: Ditëlindja ime Nxënësit/et nxiten të shkruajnë mbi festat e ditëlindjeve të tyre dhe pastaj të diskutojnë për dhuratat që kanë marrë.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - mëson këngën saktë në intonacion dhe ritëm; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.		 Fjalë kyçe: - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD me këngën.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore: njohuri për shoqërinë; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Nxënësit/et nxiten të shkruajnë mbi festat e ditëlindjeve të tyre dhe pastaj të diskutojnë për dhuratat që kanë marrë. Ata/ato dëgjojnë këngën dhe shprehin emocionet për tekstin dhe melodinë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja u mëson nxënësve/eve këngën në grup, duke respektuar karakteristikat e saj. Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe të këndimit në grup.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - diskutim me njëri-tjetrin rreth karakteristikave të këngës; - këndim duke interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion; - gjetjen e informacionit për Nikolla Zoraqin; - interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion, vetëm dhe në grup. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et (ese/filmime/ histori rreth temës), - ruhen në dosjet e tyre personale.			



Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Dëgjohet kënga “Dhuratë për ditëlindje”.

- Nxënës/et **nxiten** të flasin për këngën.
- **Mësohet** kënga sipas hapave të mëposhtëm:
 - o këndohet kënga varg pas vargu;
 - o përsëriten vargjet herë pas here;
 - o këndohet strofa;
 - o këndohet strofa dhe refreni;
 - o përsëritet kënga nga fillimi në fund;
 - o interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
 - o këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Gjatë mësimimit të këngës, kujdes tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



A_i/a_j :

- **gjen** këngë të tjera që i kushtohen gëzimit apo festave të ndryshme, duke përdorur burime të ndryshme informacioni;
- **gjen** informacion mbi mbi kompozitorin Nikolla Zoraci.

Shënime specifike:

A black and white photograph of a hand holding a small globe. A ribbon is tied around the globe in a bow. The image is positioned in the bottom right corner of the page, partially overlapping the lined writing area.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Historia,shoqëria, muzika Tema mësimore: “Sonata”		Situata e të nxënit: Orkestra dhe banda Dëgjojen dy fragmente muzikore që luhen nga banda frymore dhe një orkestër simfonike. Gjatë dëgjimit nxënësit/et gjejnë ndryshimet.	
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dëgjon në CD dhe identifikon llojin e orkestrës simfonike që dëgjon; - klasifikon sipas njohurive që merr <i>orkestrën simfonike</i> dhe llojet e tjera të formacioneve muzikore; - shpjegon përbërjen e një orkestre simfonike; - respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/ shoqeve gjatë diskutimeve.		 Fjalë kyçe: - sonata.	
 Burimet: - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja; - CD me shembuj muzikorë.		Lidhja me fushat e tjera: - shkencat shoqërore: historia; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja vendos dy fragmente muzikore të luajtura nga një violinë dhe piano dhe një orkestër simfonike, duke nxitur përsëri nxënësit/et të gjejnë se çfarë informacioni kanë për këto lloj formacionesh muzikore që dëgjojnë. Ata vetë gjejnë ndryshimet gjatë dëgjimit. Ose vendos postera/foto të formacioneve të ndryshme muzikore duke nxitur nxënësit/et të flasin rreth tyre. Të gjithë nxënësit/et shprehin njohuritë e tyre dhe respektojnë mendimin e njëri-tjetrit.			
Ndërtimi i njohurive të reja Dëgjimi i shembujve muzikorë që luhen me këto instrumente u zhvillon të dëgjuarit e kujdesëm nxënësve/eve që të kuptojnë sadopak ndryshimin jo vetëm nëpërmjet përbërjes së numrit të instrumenteve, por edhe nëpërmjet identifikimit të gjinive muzikore. Mësuesi/ja e shpjegon sonatën si formë e thjeshtë muzikore dhe përbërjen e saj në tri apo katër kohë.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për <i>rezultatet e arritura në</i> : - diskutimet me njëri-tjetrin rreth gjinisë së sonatës; - dëgjimin e pjesëve të luajtura nga instrumentet muzikore; - gjetjen e të dhënave mbi evoluimin e gjinisë së sonatës deri në ditët tona. - Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et (ese/filmime/histori rreth temës), ruhen në dosjet e tyre personale.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



Ushtrime dhe lojëra argëtuese



Dëgjohen disa fragmente muzikore në CD me sonata të luajtura nga instrumente të ndryshme muzikore.

- Nxënësit/et **nxiten** të flasin për gjininë e sonatës.

1. Plotëso fjalëkryqin e mëposhtëm.

Fuga

Tema me variacion

Rondoja

Sonata

Kanoni

Kënga

Minueti

Monodia

Polifonia

																M		S	
														M				O	
T	E				M			V	A	R			A	C		O	N		
													R	O	N	D			
	P				I			O	N	I	A				U		D		T
						U													A
			K	Ë			A										A		
					K					N	I				I				



Detyrë plotësuese për dosjen/portofolin e nxënësit/es



Ai/ajo:

- gjen** në internet kuriozitete për evoluimin deri në krijimin e orkestrës simfonike.
- gjen** në internet rreth jetës së kompozitorëve që kanë shkruar për orkestrat simfonike muzikore.

Shënime specifike:

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Teknika dhe procese		Situata e të nxënit: Muzika përmes njohurive tona	
Projekt kurrikular: “Muzika përmes njohurive tona”		Nxënësve/eve u kërkohet të gjejnë nëpërmjet internetit materiale muzikore që luhen nga instrumente dhe orkestra të ndryshme. Ata/ato mund t'i sjellin nga shtëpia ose të përdorin të shkollës nëse ka	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyçe:	
Nxënësi/ja:		- projekt;	
- bashkëpunon me të tjerët për të vendosur se si do të realizohet në grup detyra e ngarkuar mbi instrumentet muzikore dhe orkestrat;		- bashkëpunim;	
- kërkon dhe hulumton nga burime të ndryshme informacioni;		- instrumente muzikore;	
- përzgjedh informacionin e mbledhur;		- orkestra muzikore.	
- përgatit punën e vet individualisht ose në grup;			
- respekton mendimin e shokëve/shoqeve;			
- përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të paraqitur punën e vet.			
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera:	
- teksti i nxënësit;		- shkencat shoqërore dhe mjedisi:	
- burime të ndryshme informacioni;		historia dhe gjeografia;	
- paraqitje në ppt etj.		- gjuha dhe komunikimi: letërsia.	
		Lidhja me temat ndërkurrikulare	
		- të njohim kulturën e njëri-tjetrit.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Ndarja e grupeve dhe ndarja e detyrave			
Mësuesi/ja paraqet që në fillim temën: Muzika dhe të rinjtë. Më pas jep katër çështje, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit/et në grupe të veçanta, ku secili prej nxënësve/eve mund të zhvillojë aftësitë më të mira që ka:			
<i>Grupi i kërkimit të instrumenteve të ndryshme muzikore solo, në grup apo edhe në orkestër:</i>			
1. Kërkon nëpërmjet internetit dhe materialeve muzikore që mund të gjenden në shtëpi apo shkollë, muzikë që luhet me instrumente të ndryshme muzikore.			
2. Kërkon në të njëjtën mënyrë muzikë që luhet nga komplekse të vogla apo orkestra të ndryshme muzikore.			
3. Përzgjedh veprat e parapëlqyera.			
4. Regjistron në CD apo DVD vepra muzikore që luhen me instrumente apo nga orkestra muzikore.			





Grupi i kërkimit të llojeve të orkestrave muzikore:



1. Kërkon në internet, bibliotekë apo burime të tjera informacioni mbi krijimin e komplekseve të para muzikore dhe të orkestrës.
2. Përshkruan mënyrën e përsosjes së këtyre instrumenteve në kohë dhe i identifikon këto ndryshime duke i krahasuar.
3. Paraqet punën e përgatitur para grupeve të tjera, në ppt apo me mënyra të tjera.

Grupi i kërkimit të muzikës që luhet nga instrumente të ndryshme muzikore solo, në grup apo edhe në orkestër:

1. Kërkon nëpërmjet

internetit dhe materialeve muzikore që mund të gjenden në shtëpi apo shkollë, muzikë që luhet nga instrumente të ndryshme muzikore.

2. Kërkon në të njëjtën mënyrë, muzikë që luhet nga komplekse të vogla apo orkestra të ndryshme muzikore.

3. Përzgjedh veprat e parapëlqyera.

4. Regjistron në CD apo DVD vepra muzikore që luhen me instrumente apo nga orkestra muzikore.



Grupet punojnë secili në mënyrë të pavarur, i zgjedhur vetë materialet dhe mjetet për të realizuar detyrën e ngarkuar.

Ato i paraqesin produktet e realizuara në fund të tremujorit.

Nxënësit/et e vlerësojnë vetë punën e arritur nga secili grup.

Paraqitja dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- punojnë në grup;
- respektojnë mendimin e njëri-tjetrit gjatë punës;
- zhvillojnë detyrën sipas tematikës së caktuar dhe e paraqesin atë.
- **Detyrë:** Krijimet e nxënësve/eve ruhen në dosjet e tyre.



Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për pjesëmarrjen në mënyrë aktive gjatë krijimit muzikor dhe çështje të tjera lidhur me projektin.

Verifiko njohuritë e tua muzikore

1. Plotëso saktë përkufizimet.

- a) Korona është shenjë dhe tingulli zgjatet sipas dëshirës
- b) Stakato është një pikë që vihet dhe nota lexohet ose këndohet

2. Lidh me shigjetë termin në kolonën majtas me shpjegimin përkatës në kolonën djathtas.



1. pika e vlerës

a) vendoset sipër dhe poshtë notës.


2. pika e stakatos

b) vendoset sipër notës dhe brenda një gjysmërrethi.


3. pika e koronës

c) vendoset në të djathtë të notës.

3. Gjej masën 3/8 dhe 6/8. Shëno me X kohën 3/8 dhe me ✓ kohën 6/8.



4. Krijë një ushtrim në kohën 6/8, prej 8 masash muzikore.



V. VLERËSIMI

5.1. Llojet e vlerësimit: Vlerësimi i vazhdueshëm, periodik dhe përfundimtar.

Vlerësimi tremujor

Vlerësimi periodik tremujor përfshin:

- *Vlerësimin e vazhdueshëm* që del nga evidencat e vlerësimit të vazhduar të mbajtura për periudhën tremujore.
- *Vlerësimin me test ose detyrë* përmbledhëse në përfundim të periudhës tremujore.
- *Vlerësimin e dosjes (portofolit) së nxënësit/es* për periudhën tremujore.

Këto vlerësime shënohen në regjistër në kolonat përkatëse në përfundim të çdo tremujori.

Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor. Nota vjetore përfundimtare përfshin:

- *notën vjetore të vlerësimit të vazhdueshëm* të tri periudhave tremujore;
- *notën vjetore të vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse* të tri periudhave tremujore;
- *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit/es* të tri periudhave tremujore.

Secili lloj vlerësimi në notën vjetore përfundimtare ka peshën e vet në përqindje.

Tabela: Peshat në përqindje të llojeve të vlerësimit.

Lloji i vlerësimit	Pesha në përqindje
vlerësimi i vazhdueshëm	40%
vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse	40%
vlerësimi i dosjes (portofolit) së nxënësit/es	20%

Hapat për njehsimin e notës vjetore përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhdueshëm (NVV).
- Përcaktohet nota vjetore e testit ose e detyrës përmbledhëse (NVT).
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit/et/es (NVP).
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., nota 6.4 rrumbullakoset 6; nota 6.5 rrumbullakoset 7).

$$(NVV \times 0.4) + (NVT \times 0.4) + (NVP \times 0.2) = \text{Nota vjetore përfundimtare}$$

Shembull:

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Nota vjetore			Nota vjetore përfundimtare
NVV	NVT	NVP	NVV	NVT	NVP	NVV	NVT	NVP	NVV	NVT	NVP	9
8	9	10	9	10	10	8	10	10	8	10	10	

$$(8 \times 0.4) + (10 \times 0.4) + (10 \times 0.2) = 9.2$$

Nota vjetore përfundimtare 9



Shtatë kompetencat kyçe të nxënësit/et/es

Pse i shërbejnë ato

1. Komunikon dhe shprehet përmes:

- krijimit të personalitetit të vet artistik;
- kuptimit drejt të mesazheve që përcjell muzika;
- demonstrimit të një komunikimi të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave muzikore;
- shfrytëzimit të mjeteve artistike për t'u shprehur në mënyrë të pavarur rreth një muzike të caktuar.

2. Mendon përmes:

- kërkimit dhe gjetjes së informacionit muzikor në mënyrë të pavarur;
- zgjidhjes së problemeve muzikore/artistike gjatë veprimtarive;
- zhvillimit të aftësive për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese;
- ndjekjes së udhëzimeve gjatë realizimit të një krijimi muzikor.

3. Mëson për të nxënë:

- duke klasifikuar mjetet shprehëse për realizimin e një krijimi muzikor;
- duke përdorur burime të ndryshme informacioni për të plotësuar krijimin apo mendimin muzikor;
- duke krijuar në mënyrë të pavarur një detyrë të dhënë.

4. Merr nisma për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:

- duke ndërmarrë nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës dhe duke kontribuar në mënyrë krijuese;
- duke dhënë ide për projekte të ndryshme mbi muzikën në veçanti dhe artet në përgjithësi.

5. Zhvillon aspektin personal:

- duke zhvilluar besimin te vetja gjatë veprimtarive artistike;
- duke zhvilluar besimin te të tjerët me përfshirjen në mënyrë aktive në jetën shkollore dhe në komunitet.

6. Zhvillon qëndrimin e vet qytetar:

- duke bashkëpunuar me të tjerët brenda dhe jashtë shkollës pavarësisht kulturës së secilit;
- duke bashkëpunuar me të tjerët për çështje të ndryshme muzikore dhe kulturore;
- duke respektuar punën dhe kulturën e tjetrit.

7. Zhvillon aftësitë digjitale:

- duke nxjerrë informacione përmes burimeve dhe rrjeteve informuese të internetit;
- duke përdorur në funksion të muzikës mjete të ndryshme digjitale (magnetofon, video, iPad, kompjuter etj.) për të krijuar dhe për të dëgjuar.

Sa i ka përvetësuar kompetencat

	10%	20%	30%	40%	50%	60%	70%	80%	90%	100%
Kompetenca 1										
Kompetenca 2										
Kompetenca 3										
Kompetenca 4										
Kompetenca 5										
Kompetenca 6										
Kompetenca 7										

Plani vjetor mësimor

1. Rikujtojmë
2. Klasifikimi i zërave
3. Kënga “Ode gëzimi”
4. Shkalla muzikore Do maxhore
5. Kënga “Gjuha jonë, barot e trëndelinë”
6. Gradat e shkallës, toni dhe gjysmëtoni
7. Kënga “Dua më shumë Shqipërinë”
8. Intervalet muzikore
9. Akordi dhe arpezhi
10. Kënga “Malet me blerim mbuluar”
11. Klasifikimi i instrumenteve muzikore
12. Projekt nr.1 “Muzika dhe fëmijët”
13. Shkalla La minore
14. Luajmë në instrumente ushtrime në Do+ dhe La-
15. Kënga “Ju fal këngën time”
16. Nota dhe pushimi 1/16
17. Kënga “Yellow submarine”
18. Luajmë në instrumente me notën 1/16
19. Karakteristikat e instrumenteve
20. Masa e paplotësuar
21. Formacione instrumentale
22. Kënga “Eksploroj”
23. Luajmë në instrumente ushtrime me masën e paplotësuar
24. Termat dinamikë
25. Orkestra simfonike
26. Korona dhe stakato
27. Kënga “E thotë kënga çfarë ka zemra”
28. Instrumentet me tastierë
29. Koha 3/8 dhe 6/8
30. Luajmë në instrumente në kohët 3/8 dhe 6/8
31. Shenjat e shartimit
32. Format e thjeshta muzikore
33. Kënga “Dhuratë për ditëlindje”
34. Sonata
35. Projekt nr.2 “Muzika përmes njohurive tona”